



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 132

Tiranë – E premte, 14 shtator 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 93/2018, datë 6.9.2018	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën Prokuroria po heton z. Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2018.....	9065
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 4.9.2018	Për miratimin e deklaratës për pjesëmarrjen e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në Sondazhin Social Evropian – Konsorciumi Evropian i Infrastrukturës Kërkimore (ESS ERIC).....	9065
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 4.9.2018	Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës, lidhur me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes.....	9066
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 4.9.2018	Për zhvillimin e stërvitjes “Albanian Lion 2018” dhe pjesëmarrjen e Forcave Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës në stërvitjen e përbashkët, në kuadër të bashkëpunimit shumëpalësh.....	9069
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 4.9.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paraqitjes, të formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, të ndryshuar.....	9070
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 4.9.2018	Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”.....	9074

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 4.9.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 149, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar.....	9100
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 4.9.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës ‘Devoll’”	9102
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 517, datë 4.9.2018	Për miratimin e skemës zbritëse të tarifës së autostradës Milot-Morinë	9104
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018	Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.....	9105
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 30.8.2018	Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat”, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave.....	9116
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 31, datë 30.8.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 385/6, datë 26.6.2017, “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat”	9118
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 32, datë 30.8.2018	Për disa ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 1276/5, datë 27.7.2017, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave.....	9119
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 33, datë 30.8.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 1276/6, datë 27.7.2017, “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”	9122

**VENDIM**
Nr. 93/2018

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR TË KONTROLLUAR VEPRIMET DHE MOSVEPRIMET E ORGANEVE SHTETËRORE NË PARANDALIMIN DHE GODITJEN E FENOMENIT TË KULTIVIMIT DHE TRAFIKUT TË LËNDËVE NARKOTIKE, PËRFSHIRË ÇËSHTJEN PËR TË CILËN PROKURORIA PO HETON Z. SAIMIR TAHIRI, ISH-MINISTËR I BRENDSHËM”, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 30/2018

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8, 9 dhe 13, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton z. Saimir Tahiri, ish-Ministër i Brendshëm”, ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 30/2018, zgjatet për një periudhë 3-mujore nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 6.9.2018

VENDIM
Nr. 508, datë 4.9.2018

PËR MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR PJESËMARRJEN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SONDAZHIN SOCIAL EVROPIAN – KONSORCIUMI EVROPIAN I INFRASTRUKTURËS KËRKIMORE (ESS ERIC)

Në mbështetje të nenit 100 Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e deklaratës për pjesëmarrjen e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në Sondazhin Social Evropian – Konsorciumi Evropian i Infrastrukturës Kërkimore “ESS ERIC” (*European Social Survey – European Research Infrastructure Consortium*), duke marrë përsipër të gjitha detyrimet financiare, infrastrukturore dhe politike që rrjedhin nga ky anëtarësim, si vend i ftuar për raundin e nëntë të Sondazhit Social Evropian.

2. Autorizohet zëvendëskryeministri të paraqesë pranë organeve përkatëse të ESS ERIC, deklaratën për pjesëmarrje, si vend i ftuar në ESS ERIC.

3. Autorizohet zëvendëskryeministri të caktojë përfaqësuesin e Shqipërisë në asamblenë e ESS ERIC.

4. Ministri i Financave dhe Ekonomisë të kryejë pagesën për tarifën e pjesëmarrjes së Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në ESS ERIC. Shpenzimet për realizimin e sondazhit të nëntë, për koordinimin dhe zbatimin e tij do të mbulohen nga projekti “PERFORM”.

5. Me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja, autorizohet zëvendëskryeministri për të lidhur marrëveshjen përkatëse me projektin “PERFORM”.

6. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 509, datë 4.9.2018****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË FRANCËS, LIDHUR
ME BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN
E MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës, lidhur me bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE**MES KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FRANCEZE
LIDHUR ME BASHKËPUNIMIN NË
FUSHËN E MBROJTJES**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Franceze:

Të quajtura në vijim “Palët”, duke marrë parasysh marrëveshjen mes shteteve palë të Traktatit Atlantik Verior mbi statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 (i quajtur në vijim me termat “SOFA OTAN”);

Duke marrë parasysh Konventën mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze për të shmangur tatimin e dyfishtë mbi të ardhurat dhe pasuritë dhe për të parandaluar evazionin dhe shkeljet fiskale, nënshkruar në Tiranë, më 24 dhjetor 2002;

Duke marrë parasysh marrëveshjen mes Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës franceze lidhur me shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara nënshkruar në Tiranë, më 31 maj 2011 (quajtur në vijim “Marrëveshje e sigurisë”);

Duke u bazuar në objektivat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara;

Me dëshirën për të dhënë ndihmesë në paqen dhe sigurinë në Evropë;

Duke marrë parasysh vullnetin për të thelluar dhe zgjeruar kornizën e bashkëpunimit të tyre dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë,

bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Në këtë marrëveshje, shprehja:

1. “Pala Dërguese” quhet Pala së cilës i përkasin pjesëtarët e personelit që ndodhen në territorin e palës tjetër;

2. “Pala Pritëse” quhet pala mbi territorin e së cilës ndodhen, qoftë për një farë kohe, qoftë transit, forcat ose pjesëtarët e personelit të Palës Dërguese;

3. “Forcat” quhen njësitë ose trupat e forcave tokësore, ajrore, detare, të xhandarmërisë kombëtare ose të çdo lloj formacioni ushtarak të njëres ose tjetres Palë;

4. “Pjesëtarët e personelit” quhet personeli që u takon forcave të njëres nga Palët, si dhe personeli civil i njëres nga palët të punësuar nga ministria apo ministritë kompetente në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të pranishëm në territorin e palës tjetër, në kuadrin e kësaj marrëveshjeje. Për palën franceze, personeli civil mund të vijë edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme;

5. “Person në ngarkim” quhet bashkëshorti/ bashkëshortja apo çdo person tjetër që bashkëjeton si i/e martuar me një pjesëtar të personelit, si dhe fëmijët e tyre në ngarkim, në përputhje me legjislacionin e Palës Dërguese;

6. “Material” quhen mallrat, pajisjet e forcave, duke përfshirë këtu armët, municionet, automjetet ushtarake dhe çdo mjet tjetër transporti.

Neni 2

1. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët bien dakord të zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe të përcaktojnë parimet sipas të cilave do të zbatohet ajo.



2. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje varet kryesisht, për sa i përket palës franceze, nga ministri i Mbrojtjes dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe, për Palën shqiptare, nga Ministria e Mbrojtjes.

3. Modalitetet e zbatimit të kësaj marrëveshjeje përcaktohen me marrëveshje mes palëve ose me dakordësi të posaçme mes autoriteteve ministrore kompetente të palëve.

Neni 3

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, palët zbatojnë një bashkëpunim, i cili mbulon aspektet më poshtë:

- a) Konceptet e mbrojtjes dhe të sigurisë;
- b) Organizimin dhe funksionimin e forcave;
- c) Administrimin dhe menaxhimin e pjesëtarëve të personelit;
- d) Trajnimin dhe perfeksionimin vetjak dhe kolektiv të oficerëve, të nënoficerëve, të ushtarakëve të lartë dhe të personelit civil;
- e) Komunikimin dhe informacionin mes forcave ushtarake;
- f) Historinë ushtarake;
- g) Të drejtën ushtarake;
- h) Aktivitetet sportive në kuadrin e Këshillit Ndërkombëtar të Sportit Ushtarak;
- i) Fushën e armatimit dhe të pajisjeve të forcave ushtarake;
- j) Çdo aktivitet tjetër në fushën e mbrojtjes të përcaktuar bashkërisht mes palëve në varësi të interesave të tyre të ndërsjellë.

Neni 4

1. Bashkëpunimi në sektorët e përcaktuar në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje mund të marrë format e mëposhtme;

- a) Shkëmbime, vizita, praktika, shërbime me kohë të shkurtër ose të gjatë të pjesëtarëve të personelit;
- b) Dërgim ose shkëmbim oficerësh si ekspertë teknikë;
- c) Këshillime, konferenca, seminare dhe takime të tjera mbi tema të interesit të përgjithshëm;
- d) Trajnime, shkollime, kurse, specializime dhe forma të tjera perfeksionimi, ushtrime dhe trajnime të forcave;
- e) Pjesëmarrje të vëzhguesve në ushtrime ushtarake dhe manovra;

f) Bashkëpunim mes organizatave, institucioneve dhe njësive ushtarake, shkencore ose teknike të palëve;

g) Aktivitete sportive në kuadrin e Këshillit Ndërkombëtar të Sportit Ushtarak;

h) Shkëmbim përvojash dhe të dhënash të interesit të përbashkët të palëve, si dhe çdo formë tjetër bashkëpunimi të përcaktuar me marrëveshje mes palëve.

2. Vizitat zyrtare, si dhe çdo formë tjetër bashkëpunimi, realizohen sipas nevojave të përcaktuara nga palët.

3. Kushtet e zbatimit të bashkëpunimit të përcaktuara në këtë nen u nënshtrohen marrëveshjeve ose rregulloreve të posaçme.

Neni 5

1. Mbledhja mes përfaqësuesve të ministrive të mbrojtjes dhe të sigurisë së palëve mbahet sipas nevojës, një herë në territorin e njërës palë e njëherë në territorin e palës tjetër.

2. Delegacionet e secilës palë përbëhen nga atashetë respektive të mbrojtjes dhe në varësi të çështjeve në diskutim, nga përfaqësues të forcave të ndryshme dhe drejtorive të ministrive të mbrojtjes të secilës palë. Mbledhja bashkëkryesohet nga një përgjegjës i Ministrisë së Mbrojtjes të secilës palë. Sekretariati i mbledhjes caktohet rast pas rasti, nga pala dhe organizon mbledhjen.

3. Në rend të ditës të mbledhjeve regjistrohen të gjitha çështjet që palët mendojnë se nxisin bashkëpunimin dypalësh, pasi të jenë miratuar nga autoritetet përgjegjëse respektive të palëve. Rendi i ditës përcaktohet të paktën një muaj para mbledhjes.

4. Aktivitetet e bashkëpunimit vendosen me autoriteteve kompetente të ministrive të ngarkuara me mbrojtjen dhe sigurinë e palëve dhe vendosen në plane vjetore bashkëpunimi. Planet e bashkëpunimit përmbajnë aktivitetet e përcaktuara bashkërisht, si dhe objektin e tyre, mënyrën si do të kryhen, datën dhe vendin e realizimit, si dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre. Këto plane nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve.

5. Atashetë e mbrojtjes janë bashkëbiseduesit më të përshtatshëm për çdo veprim lidhur me bashkëpunimin.



Neni 6

1. Anëtarët e personelit të Palës Dërguese në territorin e Palës Pritëse nuk mund të marrin pjesë, në asnjë mënyrë, në operacionet e ruajtjes ose të vendosjes së rendit publik ose të sigurisë. Nga ana tjetër, dhe vetëm në rast kur kjo vendoset ndryshe nga palët, ata nuk mund të marrin pjesë në asnjë mënyrë në përgatitjen ose zbatimin e veprimeve luftarake ose të operacioneve të ngjashme, as në operacione të ruajtjes ose vendosjes së sovranitetit kombëtar.

2. Gjatë qëndrimit të tyre në territorin e Palës Pritëse, pjesëtarët e personelit, si dhe personat në ngarkim të Palës Dërguese respektojnë ligjet dhe rregulloret e Palës Pritëse.

Neni 7

Financimi i bashkëpunimit bazohet në rregullat e mëposhtme:

1. Pala Dërguese merr përsipër shpenzimet e udhëtimit vajtje-ardhje deri në vendin e destinuar në territorin e Palës Pritëse, për anëtarët e personelit të saj, si dhe dietat lidhur me udhëtimin, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e Palës Dërguese.

2. Për pjesëtarët e personelit të Palës Dërguese, që kryejnë udhëtime të shkurtra ose të gjata në territorin e Palës Pritëse, Pala Dërguese mbulon, po ashtu, shpenzimet e transportit, strehimit dhe ushqimit në territorin e Palës Pritëse, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e Palës Dërguese. Pala Pritëse nuk merr përsipër asnjë shpenzim lidhur me qëndrimin e pjesëtarëve të personelit dhe të personave në ngarkim që i shoqërojnë ato. Gjithsesi, Pala Pritëse mund të marrë përsipër, rast pas rasti, dhe në përputhje me programin e vizitës vetëm shpenzimet e transportit të shërbimit, si dhe komunikimet telefonike që lidhen me shërbimin me Palën Dërguese brenda territorit të saj.

3. Pala Pritëse vë falas në dispozicion të pjesëtarëve të personelit të Palës Dërguese mjetet e ndryshme të nevojshme për të ushtruar funksionet administrative.

4. Pala Pritëse shqyrton rast pas rasti mundësinë e marrjes në ngarkim të shpenzimeve shkollore, në lidhje me praktikat pranë organizmave ushtarakë të trajnimit dhe pranë njërive të Forcave të

Armatosura për anëtarët e personelit të Palës Dërguese. Modalitetet e organizimit dhe të financimit të këtyre praktikave mund të rregullohen përmes marrëveshjeve ose procedurave teknike të posaçme të bashkërenduara mes autoriteteve përkatëse të palëve.

Neni 8

E drejta për shërbime të shëndetit ushtarak të Palës Pritëse dhe kostoja financiare e këtyre shërbimeve rregullohen sipas nenit IX të NATO SOFA.

Neni 9

1. Lidhur me tatimin mbi të ardhurat dhe pasurinë, si dhe të drejtën e trashëgimisë dhe të dhurimit, anëtarët e personelit të Palës Dërguese, të cilët për arsye të detyrave zyrtare, janë rezidentë në territorin e Palës Pritëse, konsiderohen si të ishin me rezidencë fiskale në vendin e Palës Dërguese, e cila i paguan dhe u jep shpërblime të tjera të ngjashme, kjo në zbatim të Konventës mes qeverisë së Republikës Franceze dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për shmangien e tatimit të dyfishtë në fushën e të ardhurave dhe të pasurisë, si dhe për parandalimin e evazionit dhe të shkeljeve fiskale.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për personat në ngarkim për sa kohë ata nuk ushtrojnë aktivitet profesional të tyrin.

3. Pagat, trajtimet, si dhe çdo lloj shërbimi tjetër, përveç pensioneve, të paguara nga Pala Dërguese për anëtarët e personelit të saj, i nënshtrohen vetëm tatimit në shtetin e Palës Dërguese.

Neni 10

Për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara zbatohet marrëveshja e sigurisë e nënshkruar më 3 maj 2011.

Neni 11

1. Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, palët mund të bien dakord të dërgojnë përkohësisht bashkëpunëtorë ushtarakë teknikë pranë autoriteteve kompetente të njëres apo tjetres palë.

2. Palët bien dakord me marrëveshje të përbashkët mbi misionin dhe rolet e bashkëpunëtorit ushtarak teknik të dërguar sipas



pikës 1 të këtij neni. Ato vendosin me marrëveshje të përbashkët kushtet, mënyrat dhe kohëzgjatjen e këtij shërbimi të përkohshëm.

Neni 12

1. Në rezervë të klauzolave specifike të kësaj marrëveshjeje, çështjet e lidhura me statusin e pjesëtarëve të personelit dhe të personave në ngarkim rregullohen sipas klauzolave të SOFA-s.

Neni 13

1. Vdekja e një pjesëtari të personelit të Palës Dërguese në territorin e Palës Pritëse konstatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Palës Pritëse nga një mjek i autorizuar, i cili harton certifikatën e vdekjes. Pala Pritëse u transmeton autoriteteve të Palës Dërguese, në afate sa më të shpejta, një kopje të certifikuar të certifikatës së vdekjes.

2. Kur autoriteti gjyqësor kompetent i Palës Pritëse urdhëron autopsinë e të ndjerit, me iniciativën e vet ose me kërkesë të Palës Dërguese, autopsia kryhet nga një mjek i caktuar nga autoriteti gjyqësor i Palës Pritëse. Autoriteti kompetent i Palës Dërguese ose një mjek i caktuar prej saj mund të asistojë gjatë autopsisë, nëse legjislacioni i Palës Pritëse e lejon.

3. Autoritetet kompetente të Palës Pritëse sigurojnë dorëzimin e trupit të të ndjerit tek autoritetet kompetente të Palës Dërguese sapo të jetë e mundur, me qëllim riatdhesimi.

Neni 14

Kërkesat për shpërblime që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje rregullohen në përputhje me nenin VIII të SOFA OTAN.

Neni 15

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me rrugë konsultimi dhe/ose bisedimi nëpërmjet palëve.

Neni 16

1. Secila palë i njofton tjetrës përmbushjen e procedurave kombëtare të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, e cila merr efekt ditën e parë të muajit të dytë pas ditës së marrjes së njoftimit të dytë.

2. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare) dhe zgjatet në heshtje për periudha të tjera 10-vjeçare (dhjetëvjeçare), përveç rastit kur njëra nga palët e njofton tjetrën me shkrim dhe me rrugë diplomatike lidhur me synimin për t'i dhënë fund marrëveshjes, të paktën 6 (gjashtë) muaj para datës së përfundimit të marrëveshjes.

3. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në çdo çast, me shkrim, me vendim të përbashkët të të dyja palëve. Mënyrat e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve parashikohen në pikën 1 të këtij neni.

4. Secila palë mund ta denoncojë këtë marrëveshje nëpërmjet një njoftimi me shkrim, të transmetuar me rrugë diplomatike. Ky denoncim hyn në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

5. Dhënia fund apo denoncimi i kësaj marrëveshjeje nuk i çliron palët nga zbatimi i detyrimeve të kontraktuara gjatë kohës kur marrëveshja është ende në fuqi.

Hartuar në _____, më _____, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe frënge, të dyja versionet njëllor të barasvlershme ligjërisht.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës Franceze

VENDIM

Nr. 511, datë 4.9.2018

**PËR ZHVILLIMIN E STËRVITJES
“ALBANIAN LION 2018” DHE
PJESËMARRJEN E FORCAVE
USHTARAKE TË MBRETËRISË SË
BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE
DHE IRLANDËS SË VERIUT,
REPUBLIKËS SË KROACISË DHE
REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË
STËRVITJEN E PËRBASHKËT, NË
KUADËR TË BASHKËPUNIMIT
SHUMËPALËSH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, shkronja “ç”, e 14, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e



procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zhvillimin e stërvitjes “Albanian Lion 2018” dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës në stërvitjen e përbashkët, në kuadër të bashkëpunimit shumëpalësh.

2. Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 902 (nëntëqind e dy) trupave ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës, pjesëmarrës në stërvitjen “Albanian Lion 2018”.

3. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve joluftarake të evakuimit, nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije luftarake zbarkuese, helikopterë dhe forca speciale për veprimtaritë në tokë.

4. Stërvitja “Albanian Lion 2018” do të zhvillohet në periudhën 8–30 shtator 2018 në gadishullin e Karaburunit, bazën e Pashalimanit, bazën e Porto-Palermos, bazën ajrore të Rinasit, në Bizë, kepin e Palit dhe Zall-Herr.

5. Në këtë stërvitje angazhohen 902 (nëntëqind e dy) trupa ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës, 2 (dy) anije luftarake (një anije transportuese detare dhe një anije zbarkuese), 1 (një) helikopter për evakuim mjekësor, 3 (tre) avionë ushtarakë HAWK të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe 1 (një) anije për luftë kundër minave e Republikës së Kroacisë.

6. Trupat ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe të Republikës së Kroacisë, gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10101, datë 26.3.2009.

Faqe|9070

7. Trupat ushtarake të Republikës së Kosovës, gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre të përkohshëm në territorin e shteteve përkatëse, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8/2014.

8. Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, të Republikës së Kroacisë e Republikës së Kosovës do të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

9. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 512, datë 4.9.2018

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 55, DATË 27.1.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E PARAQITJES, TË
FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE,
UNIFORMAVE DHE SHENJAVE TË
POLICISË SË SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 62, 97 dhe 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në albumin bashkëlidhur vendimit nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në lidhjen 1, “Paraqitja, forma dhe të dhënat teknike të gradave të Policisë së Shtetit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. në faqen 2, pas gradës “INSPEKTOR”, shtohen gradat:

1/1.“INSPEKTOR I DYTË”;

1/2.“INSPEKTOR I PARË”.

ii. figura nr. 1, në faqen 3, zëvendësohet me figurën me të njëjtin numër, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. pas figurës nr. 1, në faqen 3, shtohen figurat nr. 1/1 dhe nr. 1/2, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Në lidhjen 4, “Shenjat e Policisë së Shtetit”, figura nr. 1, në faqen 53, zëvendësohet me figurën me të njëjtin numër, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Brendshme, programi buxhetor “Policia e Shtetit”.


3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1, figura nr. 1

Gradë e madhe shërbimi “Inspektor”



Gradë e madhe ceremoniali “Inspektor”




Gradë e vogël gjoksi “Inspektor”



Lidhja 1, figura nr. 1/1

Gradë e madhe shërbimi “Inspektor i dytë”



Gradë e madhe ceremoniali “Inspektor i dytë”




Gradë e vogël gjoksi “Inspektor i dytë”



Lidhja 1, figura nr. 1/2

Gradë e madhe shërbimi “Inspektor i parë”



Gradë e madhe ceremoniali “Inspektor i parë”




Gradë e vogël gjoksi “Inspektor i parë”



Lidhja 4, figura nr. 1

Shenjë për kursantë/studentë



Shenjë ceremoniali për kursantë/studentë



Shenjë gjoksi për kursantë/studentë



**VENDIM**

Nr. 513, datë 4.9.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E
DHËNIES DHE AUTORIZIMIT TË DISA
KATEGORIVE TË NDIHMËS
SHTETËRORE”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8/1, pika 2, 10, 11, pika 3, 12, pika 2, 13/1, pika 3, dhe 14, pika 3, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për kushtet dhe procedurat e dhënies dhe autorizimit të disa kategorive të ndihmës shtetërore”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni i Ndihmës Shtetërore dhe dhënësit e ndihmës, sipas përcaktimit në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

RREGULLORE

**PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E
DHËNIES DHE AUTORIZIMIT TË DISA
KATEGORIVE TË NDIHMËS
SHTETËRORE**

KREU I**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret, intensitetin dhe procedurën për dhënie dhe autorizimin e disa kategorive të ndihmës shtetërore.

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me rregulloren e Komisionit Evropian nr. 651/2014, datë 17 qershor 2014, “Deklarimi i disa kategorive të ndihmës, në përputhje me tregun e brendshëm, në zbatim të neneve 107 dhe 108 të Traktatit”, numër Celex 32014R0651, Fletore Zyrtare OJL 187, 26.6.2014, faqe 1–78.

Neni 2**Fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore zbatohet për kategoritë e mëposhtme të ndihmës shtetërore:

- a) Ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (në vijim “NVM”);
- b) Ndihma për punësimin e punëkërkuesve të papunë, në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara;
- c) Ndihma për trajnim;
- ç) Ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion;
- d) Ndihma për mbrojtjen e mjedisit;
- dh) Ndihma rajonale.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet, për:

a) Ndihmën për aktivitetet që kanë të bëjnë me eksportin, e cila mund të jetë e lidhur drejtpërdrejt me sasi të që eksportohen, ngritjen dhe funksionimin e një rrjeti shpërndarës ose kosto të tjera aktuale të lidhura me aktivitetin eksportues;

b) Ndihmën e kushtëzuar me përdorimin e produkteve vendëse kundrejt atyre të importuara;

c) Ndihmën e dhënë për sektorin e peshkimit dhe të produkteve të peshkut, me përjashtim të rasteve kur ndihma në këtë sektor jepet për trajnim, aksesin e ndërmarrjeve të vogla në financime, fushën e kërkimit dhe zhvillimit dhe inovacionit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme apo për punonjësit në kushte të pafavorshme dhe të atyre me aftësi të kufizuara;

ç) Ndihmën e dhënë për sektorin e prodhimeve bujqësore, me përjashtim të kompensimit për kostot shtesë, përveç atyre të transportit në rajonet e thella, siç përcaktohet në nenin 44, pika 1, shkronja “b”, ndihmën për këshillim në favor të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndihmën për riskun financiar, ndihmën për kërkim, zhvillim dhe inovacion të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ndihmën për mbrojtjen e mjedisit, për trajnim dhe ndihmë për punonjësit në kushte të pafavorshme dhe të atyre me aftësi të kufizuara;

d) Ndihmën e dhënë për sektorin e përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore, në rastet e mëposhtme:

i. aty ku shuma e ndihmës përcaktohet në bazë të çmimit ose të sasisë së produkteve të tilla të blera nga prodhues kryesorë ose të hedhura në treg nga sipërmarrësit e interesuar;

ii. aty ku ndihma është e kushtëzuar t’u transferohet pjesërisht ose tërësisht prodhuesve kryesorë;

dh) Ndihmën për ndërmarrjet në vështirësi.



Neni 3

Përkufizime

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. Termat “ndërmarrje”, “ndërmarrje të vogla e të mesme”, “skemë e ndihmës shtetërore” dhe “ndihmë individuale” kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 3 të ligjit për ndihmën shtetërore.

2. “Punëkërkues i papunë nga grupe të veçanta të disavantazhuara” është çdo person, i cili:

a) Nuk ka qenë në punë të rregullt të paguar për 6 muajt e mëparshëm;

b) Çdo person mes moshës 15 e 24 vjeç ose që ka dy vjet që ka mbaruar arsimin pa shkëputje nga puna dhe që nuk ka pasur një punë të parë të rregullt dhe të paguar;

c) Çdo person që është një anëtar i një minoriteti etnik brenda vendit dhe që kërkon zhvillimin e aftësive të tij/saj ligjore, trajnim profesional ose përvojë pune për të përmirësuar shpresat e tij për të filluar një punë të qëndrueshme;

ç) Çdo person që dëshiron të hyjë ose të rihyjë në punë, që ka qenë pa punë dhe që nuk ka qenë duke u arsimuar për dy vitet e fundit, veçanërisht çdo person që lë punën për shkak të vështirësive, për të përballuar edhe punën, edhe familjen;

d) Çdo person që jeton si beqar i rritur e që ka në ngarkim një ose më shumë persona;

dh) Çdo person që nuk ka kryer arsimin e mesëm ose ekuivalentin e tij, që nuk ka një punë ose që ka humbur punën e tij/saj apo brenda dy vjetëve pas përfundimit të arsimit të rregullt dhe nuk ka marrë një pagë të rregullt;

e) Çdo person më i madh se 50 vjeç.

3. “Punëkërkues i papunë me aftësi të kufizuara” është çdo person, i cili njihet si i tillë në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi ose ka një dëmtim fizik, mendor e psikologjik serioz.

4. “Shpenzime të detyrueshme në nivel territorial” janë detyrime të ngarkuara nga një autoritet, që u ofron ndihmë përfituesve, për të shpenzuar një shumë minimale dhe/ose të ndërmarrin një nivel minimal të aktivitetit të prodhimit në një territor të caktuar.

5. “Llogaritja e ndihmës për projektet e mëdha të investimit” është shuma maksimale e

ndihmës së lejuar për një projekt të madh investimi e përlogaritur sipas formulës së mëposhtme: shuma maksimale e ndihmës = $R \times (A + 0,50 \times B + 0 \times C)$, ku: “R” është shuma maksimale e ndihmës së zbatueshme në zonën në fjalë, në hartën rajonale të miratuar nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore dhe që hyn në fuqi në datën e dhënies së ndihmës, duke përjashtuar intensitetin e ndihmës së shtuar për NVM-në; “A” është shuma fillestare prej 50 milionë eurosh e kostove të pranueshme; “B” është pjesa e kostove të pranueshme ndërmjet 50 e 100 milionë eurove; dhe “C” është pjesa e kostove të pranueshme mbi 100 milionë euro.

6. “Paradhënie” është një hua për një projekt, e cila jepet në një ose më shumë keste dhe kushti për rimbursimin e shumës varet nga përfundimi i projektit.

7. “Ekuivalenti bruto i grantit” është shuma e ndihmës që do t'i ishte siguruar përfituesit në formën e një granti, para zbritjes së taksave ose detyrimeve të tjera.

8. “Zona më pak të populluara” janë ato zona, të cilat janë njohur nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore në vendimet individuale mbi hartat rajonale të ndihmës shtetërore në fuqi, në kohën e dhënies së ndihmës.

9. “Projekt i madh investimi” është investimi fillestar me kosto të pranueshme, që i tejkalon 50 milionë euro, të përlogaritura në bazë të çmimeve dhe kursit të këmbimit të datës së dhënies së ndihmës.

10. “Asete të prekshme” janë asetet, si: toka, ndërtesat, impiantet, makineritë dhe pajisjet.

11. “Normë e kthimit” është norma e pritshme e kthimit, ekuivalente me një normë skontimi të korrigjuar me nivelin e riskut, e cila reflekton nivelin e riskut të lidhur me një projekt, si edhe natyrën e nivelin e kapitalit që investitorët privatë planifikojnë të investojnë.

12. “Financim total” është shuma e përgjithshme e investimit për një ndërmarrje ose projekt të pranueshëm, duke përjashtuar të gjitha investimet private të siguruar sipas kushteve të tregut dhe jashtë masës përkatëse të ndihmës shtetërore.

13. “Ndihma rajonale për investim” është ndihma rajonale e dhënë për një investim fillestar ose për një investim fillestar në favor të një aktiviteti të ri ekonomik.



14. “Ndhimja rajonale operacionale” është ndihma që ka për qëllim të reduktojë shpenzimet aktuale të një ndërmarrjeje, e cila nuk ka të bëjë me një investim fillestar. Kjo përfshin kategoritë e kostove si ato të personelit, materialeve, shërbimeve të kontraktuara, energjisë, mirëmbajtjes, qirasë, administratës, por jo detyrimet e zhvlerësimit dhe kostot e financimit nëse këto kanë qenë të përfshira në kostot e pranueshme në kohën e dhënies së ndihmës së investimit.

15. “Investim fillestar” është:

a) Një investim në asete të prekshme dhe jo të prekshme të lidhura me themelimin e një ndërmarrjeje të re, shtrirjen e kapacitetit të një ndërmarrjeje ekzistuese, shumëllojshmërinë e prodhimit të një ndërmarrjeje drejt produkteve, të cilat nuk kanë qenë të prodhuara më parë në një ndërmarrje ose një ndryshim themelor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese; ose

b) Blerja e aseteve që i përkasin një ndërmarrjeje, e cila është mbyllur ose do të mbyllet nëse nuk do të ishte blerë dhe që është blerë nga një investitor që nuk ka lidhje me shitësin. Nuk përfshihet në këtë përkufizim blerja e aksioneve të një ndërmarrjeje.

16. “Investim fillestar në favor të një aktiviteti të ri ekonomik” është:

a) Një investim në asete të prekshme dhe jo të prekshme, që lidhen me themelimin e një ndërmarrjeje ose me diversifikimin e aktivitetit të një ndërmarrjeje, me kusht që aktiviteti i ri të mos jetë i njëjtë ose i ngjashëm me aktivitetin e mëparshëm të ndërmarrjes;

b) Blerja e aseteve, që i përkasin një ndërmarrjeje, e cila është mbyllur ose do të mbyllet nëse nuk do të ishte blerë, dhe që është blerë nga një investitor, i cili nuk ka lidhje me shitësin, me kusht që aktiviteti i ri që kryhet, duke përdorur asetet e blera, të mos jetë i njëjtë ose i ngjashëm me aktivitetin e kryer në ndërmarrje përpara blerjes.

17. “Zona të asistuar” janë zonat e përcaktuara në hartën rajonale të ndihmës shtetërore e miratuar nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore.

18. “Data e dhënies së ndihmës” është data kur e drejta ligjore për të marrë ndihmë i akordohet përfituesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

19. “Zona të pranueshme për ndihmën operacionale” janë zona të largëta ose zona më pak të populluara, siç përcaktohet në hartën rajonale në fuqi të ndihmës së miratuar nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore.

20. “Punësim i lidhur drejtpërdrejt me projektin e investimit” është punësimi, i cili ka të bëjë me aktivitetin e lidhur me investimin, përfshirë krijimin e vendeve të punës, si rrjedhojë e rritjes së shfrytëzimit të kapacitetit të krijuar nga investimi.

21. “Bashkëpunimi organizativ” është zhvillimi i strategjive të përbashkëta të biznesit ose i strukturave të menaxhimit, sigurimi i shërbimeve të përbashkëta ose shërbimeve që lehtësojnë bashkëpunimin, kryerjen e aktiviteteve të koordinuara, si p.sh.: për qëllime kërkimore ose marketingu, mbështetja për rrjetet dhe grupet, përmirësimi i aksesit dhe komunikimit, përdorimi i mjeteve të përbashkëta për të nxitur sipërmarrjen dhe tregtinë me NVM-në.

22. “Shërbime këshillimi në fushën e bashkëpunimit” përfshijnë këshillime, mbështetje dhe trajnime për të nxitur shkëmbimin e njohurive e përvojave dhe për rritjen e bashkëpunimit.

23. “Shërbime mbështetëse në fushën e bashkëpunimit” është sigurimi i hapësirave të zyrës, faqeve të internetit, bazës së të dhënave, bibliotekave, studimeve të tregut, manualeve, dokumenteve të raporteve dhe modeleve të tyre.

24. “Investitor i pavarur privat” është një investitor privat, i cili nuk është bashkaksionar i ndërmarrjes së pranueshme ku ai investon, përfshirë *business angels*, financues privat, dhe institucionet financuese, pavarësisht nga pronësia, deri në atë masë sa të mbajnë përgjegjësinë e plotë të rrezikut për sa u përket investimeve të tyre. Pas themelimit të një ndërmarrjeje të re, investitorët privatë, përfshirë edhe financuesit, konsiderohen si të pavarur nga ajo ndërmarrje.

25. “Shitja e parë tregtare” është shitja e parë që kryhet nga një ndërmarrje në një treg produktesh ose shërbimesh, me përjashtim të shitjeve të kufizuara për të testuar tregun.

26. “Ndërmarrje e vogël dhe e mesme e palistuar” është një NVM, e cila nuk është e regjistruar në regjistrin zyrtar të një burse, me përjashtim të sistemeve alternative tregtare.



27. “Investim pasues” është një investim shtesë për riskun financiar në një ndërmarrje të një ose më shumë serive investuese në lidhje me rrezikun financiar.

28. “Kapital zëvendësues” është blerja e aksioneve ekzistuese në një ndërmarrje nga një investitor ose aksionar i mëparshëm.

29. “Ndërmarrje novatore” është një ndërmarrje:

a) E cila mund të demonstrojë, bazuar në një vlerësim të kryer nga një ekspert i jashtëm, se në një të ardhme të afërt do të zhvillojë produkte, shërbime ose metoda të reja ose kryesisht të përmirësuara në krahasim me teknologjinë e fjalës së fundit në industrinë e saj dhe të cilat mbartin një rrezik të dështimit teknologjik apo industrial; ose

b) Kostot e kërkimit dhe zhvillimit të së cilës përfaqësojnë të paktën 10% të kostove totale operative, në të paktën një nga tre vjetët që i paraprin dhënies së ndihmës ose, në rast të një ndërmarrjeje fillestare pa të dhëna financiare, gjatë auditit aktual të vitit financiar, të certifikuar nga një auditues i jashtëm.

30. “Kapital i vet” është e drejta e pronësisë në një ndërmarrje në formën e aksioneve të emetuara për investitorët.

31. “Pjesëmarrje në kapital”, instrumentet financiare për të cilat kthimi të mbajtësi është bazuar në fitim ose humbje të ndërmarrjes dhe që janë të pasiguruara në rast të performancës së dobët të ndërmarrjes.

32. “Kapital privat” (i ndryshëm nga publik) është kapitali i vet apo pjesëmarrja në kapital, të cilat nuk janë të listuara në bursë, përfshirë kapitalin e riskut.

33. “Kapitali fillestar” është financimi për studimin, aksesin dhe zhvillimin e konceptit fillestar, që i paraprin fazës së krijimit të ndërmarrjes.

34. “Kapital për ngritjen”, financim i një ndërmarrjeje, e cila nuk ka shitur produktet apo shërbimet e saj në treg dhe nuk ka nxjerrë ende fitim për zhvillimin e produktit e marketingut fillestar.

35. “Strategji daljeje”, strategji për likuidimin e kapitalit të riskut apo fondit të kapitalit privat në përputhje me një plan, për të maksimizuar kthimin, përfshirë shitjen e biznesit, likuidimin, shlyerjet e aksioneve/kredive preferenciale, shitje

te një investitor i kapitalit të riskut, shitje të një institucion financiar dhe shitje me ofertë publike, përfshirë ofertat publike fillestare.

36. “Organizatë e kërkimeve dhe përhapjes së njohurive” është një entitet (si universitetet ose institutet e kërkimit, agjencitë e transferimit të teknologjisë, ndërmjetësit novatorë, entitete bashkëpunuese virtuale ose fizike me orientim kërkimor), pavarësisht statusit të tij ligjor ose mënyrës së financimit, qëllimi kryesor i të cilit është të kryejë në mënyrë të pavarur kërkime themelore, industriale ose zhvillime eksperimentale ose të përhapë gjerësisht rezultatet e këtyre aktiviteteve me anë të mësimdhënies, publikimit ose transferimit të njohurive. Kur një entitet i tillë kryen, gjithashtu, edhe aktivitete ekonomike, atëherë financimi, kostot dhe të ardhurat nga këto aktivitete ekonomike duhet të llogariten veçmas. Ndërmarrjet, që ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi një entitet të tillë, p.sh. në cilësinë e aksionarëve ose anëtarëve, nuk mund të gëzojnë akses preferencial për rezultatet e gjeneruara.

37. “Kërkim themelor” është një punë eksperimentale ose teorike e ndërmarrë kryesisht për të fituar njohuri të reja themelore bazë, rreth fenomeneve dhe fakteve të vëzhgueshme, pa ndonjë aplikim apo përdorim direkt tregtar në funksion.

38. “Kërkim industrial” është një kërkim i planifikuar ose një hetim kritik, që synon përvetësimin e njohurive ose aftësive, zhvillimin e produkteve të reja, metodave ose shërbimeve, ose realizimin e një përmirësimi domethënës të produkteve, metodave ose shërbimeve ekzistuese. Ky kërkim përfshin krijimin e komponentëve të sistemeve komplekse dhe mund të përfshijë ndërtimin e prototipave në një mjedis laboratorik ose në një mjedis të pajisur me ndërfaqe simuluese të sistemeve ekzistuese, gjithashtu edhe të produktet pilote eksperimentale, nëse kjo është e nevojshme për qëllime të kërkimit industrial e, veçanërisht, për vlefshmërinë e teknologjisë së përgjithshme.

39. “Zhvillim eksperimental” është përvetësimi, kombinimi, modelimi dhe përdorimi i njohurive ekzistuese dhe aftësive shkencore, teknologjike dhe komerciale ose i njohurive të tjera të përshtatshme dhe i aftësive, me qëllim zhvillimin ose përmirësimin e produkteve,



metodave dhe shërbimeve të reja. Kjo mund të përfshijë gjithashtu edhe aktivitete që kanë për qëllim përkufizimin e koncepteve, planifikimin dhe dokumentimin e produkteve, metodave dhe shërbimeve të reja. Zhvillimi eksperimental mund të përfshijë prototipat, demonstrimin, produktet pilote, testimin dhe vlefshmërinë e produkteve, metodave ose shërbimeve të reja, në mjedise me kushte reale, ku objektivi kryesor është përmirësimi i mëtejshëm teknik i produkteve, metodave ose i shërbimeve të cilat nuk janë të përfunduara në thelb. Mund të përfshihet edhe zhvillimi i një prototipi ose produkti pilot të përdorshëm për synime tregtare, i cili është domosdoshmërisht produkt final tregtar dhe kostoja e prodhimit e të cilit është shumë e lartë vetëm për qëllime të demonstrimit dhe të vlefshmërisë. Zhvillimi eksperimental nuk përfshin ndryshimet periodike ose rutinë, që u bëhet produkteve ekzistuese, linjave të prodhimit, industrisë përpunuese, shërbimeve dhe operacioneve në proces, edhe nëse këto ndryshime mund të sjellin përmirësime.

40. “Kostot e personelit” janë kostot për kërkuesit, teknikët dhe stafin mbështetës të punësuar në projektet ose aktivitetet në fjalë.

41. “Kushte të barabarta” janë kushtet e transaksionit ndërmjet palëve kontraktuese, të cilat nuk ndryshojnë nga ato të përcaktuara mes ndërmarrjeve të pavarura dhe nuk përmbajnë ndonjë element të marrëveshjeve të fshehta. Çdo transaksion që rezulton nga një procedurë e hapur, transparente dhe e paanshme konsiderohet të ketë plotësuar parimin e barazisë.

42. “Infrastrukturë për qëllime kërkimore” janë godinat, burimet dhe shërbimet përkatëse, të cilat janë përdorur nga komuniteti shkencor, për të kryer kërkime në fushat e tyre përkatëse dhe që mbulojnë instrumentet shkencore, burimet e bazuara në njohuri, si: koleksionet, arkivimin, ose informacionin e strukturuar shkencor, duke siguruar infrastrukturën bazë të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit, si: rrjetin, informatikën, programet kompjuterike (*software*) dhe komunikimin ose çdo entitet tjetër të një natyre unike thelbësore për realizimin e kërkimit. Infrastruktura të tilla mund të jenë vendosur në një vend të vetëm ose të shpërndarë.

43. “Klastera inovacioni” janë strukturat ose grupet e organizuara të palëve të pavarura (si

ndërmarrjet e sapokrijuara, të vogla, të mesme dhe të mëdha, gjithashtu edhe organizatat e kërkimit dhe shpërndarjes së informacionit, organizatat jofitimprurëse dhe aktorë të tjerë përkatës ekonomikë), të krijuar për të nxitur aktivitete të reja me anë të promovimit, ndarjen e pajisjeve, shkëmbimin e njohurive dhe ekspertizës, duke kontribuar në mënyrë të efektshme në transferimin e dijeve, rrjetit, shpërndarjes së informacionit dhe bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve dhe organizatave të tjera.

44. “Personel shumë i kualifikuar” është stafi i cili zotëron një diplomë të arsimit të lartë dhe që ka të paktën 5 vjet përvojë profesionale të përshtatshme, e cila mund të përfshijë edhe trajnimin në nivel doktore.

45. “Shërbime këshilluese në fushën e inovacionit” janë shërbimet këshilluese, mbështetja dhe trajnimet në fushën e transferimit të njohurive, përvetësimit, mbrojtjes dhe shfrytëzimit të aseteve të paprekshme, përdorimi i standardeve dhe i rregulloreve të referuara.

46. “Shërbime për mbështetjen e inovacionit” është siguri i hapësirave të zyrës, baza e të dhënave, bibliotekat, studimi i tregut, laboratorët, sistemet e etiketimit të cilësisë, testimet dhe certifikimet për zhvillimin e produkteve, metodave dhe shërbimeve më efikase.

47. “Inovacion organizativ” është zbatimi i një metode të re organizative në praktikën e biznesit, organizimi i mjedisit të punës ose marrëdhënieve të jashtme të një ndërmarrjeje, duke përjashtuar ndryshimet, të cilat bazohen në metoda organizative tashmë në përdorim nga ndërmarrjet, ndryshimet në strategjitë e menaxhimit, bashkimet dhe blerjet, duke i dhënë fund përdorimit të një procesi, zëvendësimi i thjeshtë i kapitalit ose kohëzgjatja e tij, ndryshimet që rrjedhin kryesisht nga ndryshimet në çmimet e faktorëve të prodhimit, kërkesave të konsumatorëve, lokalizimit, ndryshimeve të tjera periodike, sezonale dhe ciklike dhe nga ndryshimet në tregtimin e produkteve të reja ose të përmirësuara në mënyrë të konsiderueshme.

48. “Procesi i inovacionit” është zbatimi i një metode të re ose të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, të prodhimit dhe shpërndarjes (përfshirë ndryshime të rëndësishme në teknikë, pajisje ose *software*), duke përjashtuar ndryshimet apo përmirësimet e vogla, rritjet në kapacitetin e



prodhimit dhe shërbimit nëpërmjet shtimit të sistemeve prodhuese ose logjistike, të cilat janë shumë të ngjashme me ato që janë tashmë në përdorim, duke i dhënë fund përdorimit të një procesi, zëvendësimi i thjeshtë i kapitalit ose kohëzgjatja e tij, ndryshimet që rrjedhin kryesisht nga ndryshimet në çmimet e faktorëve të prodhimeve, kërkesave të konsumatorëve, lokalizimit, ndryshimeve të tjera periodike, sezonale dhe ciklike dhe nga ndryshimet në tregtimin e produkteve të reja ose të përmirësuara në mënyrë të konsiderueshme.

49. “Transferim i përkohshëm” është punësimi i përkohshëm i stafit nga një përfitues ku të punësuarit gëzojnë të drejtën të kthehen te punëdhënësi i mëparshëm.

50. “Përgjegjësitë e balancimit” janë përgjegjësitë për mungesën e balancimit (në lidhje me devijimet ndërmjet prodhimit, konsumimit dhe transaksioneve tregtare) të një pjesëmarrësi tregtar ose përfaqësuesit të tij të zgjedhur, referuar si “Palë përgjegjëse për balancimin” brenda një periudhe të caktuar, referuar si “Periudha për zgjidhjen e mungesës së balancimit”.

51. Termat “energjia nga burime të rinovueshme”, “burime të energjisë së rinovueshme”, “biokarburantet”, “biomasë”, “fondi për eficiencën e energjisë” dhe “menaxheri i fondit për eficiencën e energjisë” kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së rinovueshme dhe eficiencës së energjisë.

52. Termat “mbrojtja e mjedisit”, “vend i ndotur”, “parimi “ndotësi pagan””, “ripërdorimi”, “përgatitje për ripërdorimin” dhe “riciklimi” kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi në fushën e mjedisit.

KREU II

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Neni 4

Kufijtë e lejuar

1. Rregullat e përcaktuara në këtë rregullore zbatohen për ndihmën shtetërore që nuk tejkalojnë kufijtë e mëposhtëm:

a) 100 milionë euro për kostot e pranueshme për ndihmën rajonale për investim, të përlllogaritura sipas mekanizmit të parashikuar në këtë rregullore.

b) 7,5 milionë euro për ndërmarrje dhe projektin e investimit për ndihmën e investimeve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

c) 2 milionë euro për çdo ndërmarrje dhe projekt për ndihmën për këshillimin në favor të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

ç) 2 milionë euro për çdo ndërmarrje, çdo vit, për ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për pjesëmarrje në panairë;

d) 15 milionë euro për çdo ndërmarrje të pranueshme për ndihmën për riskun financiar;

dh) ndihmën për ndërmarrjet e sapokrijuara: shumat e përcaktuara për çdo ndërmarrje në nenin 17(3), (4) dhe (5);

e) Ndihmën për kërkim dhe zhvillim:

i. nëse projekti është kryesisht kërkim themelor, 40 milionë euro për çdo ndërmarrje dhe për projekt; në këtë rast, kushti konsiderohet i plotësuar kur më shumë se gjysma e kostove të pranueshme të projektit përfshin aktivitete që i përkasin kategorisë së kërkimeve themelore;

ii. nëse projekti është kryesisht kërkim industrial, 20 milionë euro për çdo ndërmarrje, për projekt; në këtë rast, kushti konsiderohet i plotësuar kur më shumë se gjysma e kostove të pranueshme të projektit përfshin aktivitete që i përkasin kategorisë së kërkimit industrial ose brenda aktiviteteve të kërkimit industrial dhe kërkimit themelor të marra së bashku;

iii. nëse projekti është kryesisht zhvillim eksperimental, 15 milionë euro për çdo ndërmarrje, për projekt; në këtë rast, kushti konsiderohet i plotësuar kur më shumë se gjysma e kostove të pranueshme të projektit përfshin aktivitete që i përkasin kategorisë së zhvillimit eksperimental;

iv. nëse ndihma për projektet e kërkimit dhe zhvillimit është dhënë në formën e parapagimeve të shlyeshme, e cila, në mungesë të një metodologjie të pranueshme për të përlllogaritur ekuivalentin bruto të grantit, është e shprehur si përqindje e kostove të pranueshme dhe masa siguron se në rast të një rezultati të suksesshëm të projektit, e përcaktuar në bazë të një hipoteze të arsyeshme dhe të matur, parapagesa do të rishlyhet sipas një norme interesi, e cila të jetë të paktën e barabartë me normën e zbritjes në zbatim në kohën e dhurimit të grantit, shumat e referuara në nënndarjet (i) deri në (iv) do të rriten me 50%;



ë) 20 milionë euro për infrastrukturë për ndihmën për investimet në studimin e infrastrukturës;

f) 7,5 milionë euro për çdo njësi për ndihmën për klasterat;

g) 5 milionë euro për çdo ndërmarrje ose projekt për ndihmën novatore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

gj) 2 milionë euro për çdo projekt të trajnimit për ndihmën për trajnim;

h) 5 milionë euro për çdo ndërmarrje, për çdo vit për ndihmën për punësimin e punëkërkuesve të papunë në vështirësi;

i) 10 milionë euro për çdo ndërmarrje, për çdo vit për ndihmën për punësimin e punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara në formën e subvencionit të pagës;

j) 10 milionë euro për çdo ndërmarrje, për çdo vit për ndihmën për kompensimin e kostove shtesë për punonjësit me aftësi të kufizuara;

k) 15 milionë euro për çdo ndërmarrje, për çdo projekt investues për mbrojtjen e mjedisit, duke përjashtuar ndihmën e investimeve për rehabilitimin e zonave të ndotura dhe ndihma për rrjetin shpërndarës;

l) 20 milionë euro për çdo ndërmarrje, për çdo projekt investimi për ndihmën e investimeve për pastrimin e zonave të ndotura;

ll) 15 milionë euro për çdo ndërmarrje për projekt për ndihmën operationale për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme. Kur ndihma jepet në bazë të një procesi konkurrues tenderimi sipas nenit 30, 150 milionë euro për çdo vit, duke marrë parasysh buxhetin e kombinuar e të gjitha skemave që i përkasin nenit 30;

m) 50 milionë euro për çdo ndërmarrje, për çdo projekt investues për ndihmën për investime në infrastrukturën energjetike.

2. Kufijtë e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni duhet të respektohen duke mos i ndarë skemat e ndihmës ose projektet e ndihmës shtetërore në mënyrë artificiale.

3. Në rastet e ndihmës apo skemave të ndihmës shtetërore që tejkalojnë kufijtë e parashikuar në këtë dispozitë, Komisioni i Ndihmës Shtetërore autorizon, rast pas rasti, dhënien e ndihmës në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë rregullore, si dhe në metodologjinë e miratuar me udhëzim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

Neni 5

Transparenca e ndihmës

1. Ndihma është transparente kur ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi përpara dhënies së ndihmës, duke vlerësuar paraprakisht konkurrencën në tregun përkatës, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në këtë rregullore.

2. Kategoritë e mëposhtme të ndihmës konsiderohen transparente:

a) Ndihma e dhënë në formën e granteve dhe të subvencionit;

b) Ndihma në formë borxhi ose kredie, nëse ekuivalenti bruto i grantit është llogaritur mbi bazën e normës së interesit që zbatohet në kohën e dhënies së grantit;

c) Ndihma në formën e garancisë, nëse:

i. përfituesi i ndihmës nuk përmbush kushtet për nisjen e një procedure falimentimi sipas legjislacionit në fuqi; dhe

ii. garancia nuk kalon 80% të kredisë që garanton dhe pjesa e garantuar e kredisë nuk kalon shumën prej 522 500 000 (pesëqind e njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekësh;

ç) Ndihma në formën e lehtësirave fiskale, nëse kufiri i zbatueshëm për ndihmën në këtë rregullore nuk tejkalohet;

d) Ndihma në formën e paradhënies, në rast se shuma e parapaguar nuk tejkalon intensitetin maksimal të lejuar për kategorinë përkatëse ose nëse para zbatimit të masës, metodologjia e llogaritjes së ekuivalentit bruto të grantit të paradhënies është pranuar pasi i është njoftuar strukturës përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore. Në rast se vlera e ndihmës është shprehur në formën e intensitetit të ndihmës, shuma totale e paradhënies, e shprehur si një përqindje e kostove të pranueshme, nuk duhet të kalojë intensitetin e ndihmës së zbatuar për kategorinë përkatëse.

Neni 6

Efekti nxitës

1. Kjo rregullore zbatohet vetëm për ndihmën shtetërore që ka efekt nxitës.

2. Ndihma konsiderohet të ketë efekt nxitës nëse përfituesi ka dorëzuar një aplikim me shkrim për ndihmën shtetërore pranë dhënësit të ndihmës shtetërore, para fillimit të punimeve të



projektit ose aktivitetit. Aplikimi për këtë ndihmë duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) Emrin dhe madhësinë e ndërmarrjes;
- b) Përshkrimin e projektit, përfshirë datat e fillimit e përfundimit të tij;
- c) Vendndodhjen e projektit;
- ç) Listën e kostove të projektit;
- d) Llojin e ndihmës (grant, hua, garanci, paradhënie ose në formë tjetër) dhe shumën e fondit publik që nevojitet për projektin.

3. Ndihma “*ad hoc*” që u jepet ndërmarrjeve të mëdha konsiderohet të ketë efekt nxitës, kur, përveç plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 2, dhënësi i ndihmës, pas verifikimit të dokumentacionit të përgatitur nga përfituesi, para dhënies së ndihmës, arrin të provojë se ndihma sjell një ose më shumë nga rezultatet e mëposhtme:

a) Në rastin e ndihmës rajonale për investim, në mungesë të dhënies së ndihmës, projekti nuk mund të zbatohej ose nuk mund t'i sjellë mjaftueshëm përfitime përfituesit;

- b) Në të gjitha rastet e tjera:
- shtim faktik/konkret të qëllimit të projektit/aktivitetit si rezultat i ndihmës; ose
 - shtim faktik/konkret të të gjithë shumës totale të shpenzuar nga përfituesi për projektin/aktivitetin për shkak të ndihmës; ose
 - përsheptim i përfundimit të punimeve të projektit/aktivitetit në fjalë.

4. Kushtet e pikave 2 e 3 nuk zbatohen për masat fiskale. Ndihma në formën e lehtësirave fiskale konsiderohet se ka efekt nxitës, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Ndihma shtetërore parashikon të drejtën për të përfituar ndihmë, kur plotësohen kriteret objektive dhe nuk lidhet me ushtrimin e mëtejshëm të diskrecionit të dhënësit të ndihmës; dhe

b) ndihma është miratuar dhe është në fuqi para se të kenë filluar punimet e projektit të subvencionuar ose të aktivitetit, përveç rastit të skemave fiskale të mëvonshme, ku aktiviteti ka qenë më herët i mbuluar nga skemat e ndihmës shtetërore në formën e përfitimeve fiskale.

5. Konsiderohen se kanë efekt nxitës, në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) Ndihma për punësimin e punëkërkuesve të papunë në vështirësi në formën e subvencionit të

pagës, nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 18 të kësaj rregulloreje;

b) Ndihma rajonale operationale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 44 të rregullores.

Neni 7

Intensiteti i ndihmës dhe kostot e pranueshme

1. Për qëllim të llogaritjes së intensitetit të ndihmës dhe kostove të pranueshme, të gjitha vlerat e përdorura, janë ato të llogaritura para zbritjes së taksave apo detyrimeve të tjera. Kostot e pranueshme shoqërohen me dokumente justifikuese, të cilat duhet të jenë të qarta, specifike dhe të përditësuara.

2. Kur ndihma është dhënë në një formë tjetër përveç grantit, shumata e ndihmës është ekuivalenti bruto i grantit.

3. Ndihma e dhënë në disa këste zbritet nga shumata e vlerës së saj në momentin e dhënies së ndihmës. Kostot e pranueshme zbriten nga shumata e vlerës së tyre në momentin e dhënies së ndihmës. Norma e interesit e përdorur për qëllime të zbritjes nga shumata është ajo normë e zbritjes që është zbatuar në momentin e dhënies së ndihmës.

4. Kur ndihma është dhënë me anë të përfitimeve fiskale, zbritja e kësteve të ndihmës realizohet në bazë të normës së zbritjes, e zbatuar në kohën kur është realizuar përfitimi fiskal.

5. Ndihma e dhënë në formën e paradhënies, në mungesë të një metodologjie të pranueshme për të llogaritur ekuivalentin bruto të grantit, shprehet si përqindje e kostove të pranueshme dhe masa parashikon që, në rast të përfundimit të suksesshëm të projektit, paradhënia shlyhet sipas një norme interesi që është të paktën e barabartë me normën e zbritjes së shumës që është zbatuar në momentin e dhënies së ndihmës. Intensiteti maksimal i ndihmës i përcaktuar në kreun III mund të rritet me 10 pikë përqindjeje.

6. Kur ndihma rajonale jepet në formën e paradhënies, intensiteti maksimal i ndihmës i përcaktuar në hartën rajonale të ndihmës në fuqi në momentin e dhënies së ndihmës nuk mund të rritet.



Neni 8

Mbledhja e ndihmës

1. Për të përcaktuar nëse është respektuar kufiri i përcaktuar në nenin 4 dhe intensiteti maksimal i ndihmës, i parashikuar në kreun III të kësaj rregulloreje, merret në shqyrtim shuma totale e ndihmës shtetërore e dhënë në favor të aktivitetit, projektit ose ndërmarrjes.

2. Ndihma në kosto të identifikueshme të pranueshme, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, mund të mbledhet me:

a) Çdo ndihmë tjetër shtetërore, për sa kohë që këto masa kanë të bëjnë me kosto të ndryshme të pranueshme të identifikueshme;

b) Çdo ndihmë tjetër shtetërore, në lidhje me të njëjtat kosto të pranueshme, të cilat mund të mbivendosen në mënyrë të pjesshme ose të plotë, vetëm nëse një mbledhje e tillë nuk e tejkalon intensitetin e ndihmës ose shumën e ndihmës më të lartë të zbatueshme për këtë ndihmë sipas kësaj rregulloreje.

3. Ndihma shtetërore në këtë rregullore nuk mund të mbledhet me një ndihmë “*de minimis*” për sa u përket kostove të njëjta të pranueshme, nëse ajo tejkalon intensitetin e ndihmës të parashikuar në kreun III të kësaj rregulloreje.

4. Ndihma në favor të punëkërkuësve të papunë me aftësi të kufizuara mund të mbledhet me një ndihmë tjetër të parashikuar në këtë rregullore, në lidhje me kostot e njëjta të pranueshme, edhe kur pas mbledhjes kalohet pragu i parashikuar në këtë rregullore, me kusht që intensiteti i ndihmës të mos kalojë 100% të kostove përkatëse përgjatë çdo periudhe në të cilën punëkërkuësit e papunë janë punësuar.

Neni 9

Monitorimi i ndihmës shtetërore

1. Dhënësi i ndihmës shtetërore merr masa të publikojë në faqen zyrtare të internetit:

a) Informacionin përmbledhës të referuar në formatin e standardizuar të përcaktuar në shtojcën I ose *link*-un e informacionit;

b) Tekstin e plotë të çdo mase ndihme ose *link*-un e tekstit të plotë;

c) Informacionin e referuar në shtojcën II për çdo dhënie të ndihmës individuale që i tejkalon 500 000 (pesëqind mijë) euro.

2. Informacioni i referuar në pikën 1(c) të këtij neni organizohet dhe bëhet i aksesueshëm në një mënyrë të standardizuar. Informacioni i referuar në pikën 1 publikohet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e dhënies së ndihmës ose për ndihmën në formën e përfitimit fiskal brenda 1 viti nga data e deklarimit të tatimeve dhe ruhet për të paktën 10 (dhjetë) vjet nga data e dhënies së ndihmës.

3. Komisioni i Ndihmës Shtetërore publikon në faqen e tij të internetit:

a) Adresat elektronike të faqeve të internetit të dhënësve të ndihmës shtetërore të referuar në pikën 1 të këtij neni;

b) Informacionin përmbledhës të skemës.

KREU III

KATEGORITË E NDIHMËS SHTETËRORE

SEKSIONI I

**KUSHTET DHE PROCEDURAT E
DHËNIES SË NDIHMËS PËR
NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË
MESME**

Neni 10

**Ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të
mesme**

1. Ndihma shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të lejohet sipas kategorive, si më poshtë vijon:

a) Ndihmë për investime;

b) Ndihmë për ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara nga sipërmarrëset femra;

c) Ndihmë për këshillim;

ç) Ndihma për pjesëmarrje në panaire;

d) Ndihma për riskun financiar;

dh) Ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të sapokrijuara.

2. Ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme nuk jepet për ndërmarrjet në sektorin e nxjerrjes së qymyrit ose ndërmarrjet në vështirësi.

Neni 11

Ndihma për investime

1. Ndihma për investime në favor të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.



2. Kostot e pranueshme përfshijnë njërën nga/ose të dyja kostot e mëposhtme:

a) Kostot e investimit në asete të prekshme dhe të paprekshme;

b) Kostot e parashikuara të pagave në lidhje me punësimin e krijuar drejtpërsëdrejti nga projekti i investimit, të përlllogaritura gjatë një periudhe dyvjeçare.

3. Një investim konsiderohet si kosto e pranueshme, me kusht që të jetë:

a) Një investim në asete të prekshme dhe/ose të paprekshme për ngritjen e një ndërmarrjeje të re apo zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, për të diversifikuar prodhimin e një ndërmarrjeje me produkte të reja shtesë ose një ndryshim rrënjësor në procesin e përgjithshëm të prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese; ose

b) Blerje e aseteve, që i përkasin një ndërmarrjeje, në rast se plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. ndërmarrja është mbyllur ose do të mbyllet nëse nuk do të ishte blerë;

ii. asetet janë blerë nga një palë e tretë që nuk ka lidhje me blerësin;

iii. transaksioni është kryer në përputhje me kushtet e tregut.

4. Kushti i parashikuar në pikën 3, shkronja “b”, nënndarja “ii”, të këtij neni, nuk zbatohet kur ndërmarrja e vogël kalon në pronësi të një anëtarit të familjes së pronarit të parë ose një punonjësi. Blerja e aksioneve/kuotave të një ndërmarrjeje nuk përbën investim.

5. Asetet e paprekshme duhet të plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Të përdoren vetëm në ndërmarrjen që ka përfituar ndihmën;

b) Të konsiderohen si asete të amortizueshme;

c) Të blihen, në përputhje me kushtet e tregut, nga një palë e tretë, që nuk ka lidhje me blerësin;

ç) Të përfshihen në asetet e ndërmarrjes për të paktën tre vjet.

6. Vendet e punës të krijuara në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti i investimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Të krijohen brenda tre vjetëve nga koha e përfundimit të investimit;

b) Rritjen neto të numrit të punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, në krahasim me mesataren e 12 muajve të mëparshëm;

c) Vendet e punës duhet të ruhen për një periudhë minimale trevjeçare nga data e plotësimit për herë të parë.

7. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë:

a) 20% të kostove të pranueshme për ndërmarrjet e vogla;

b) 10% të kostove të pranueshme për ndërmarrjet e mesme.

Neni 12

Ndihmë për ndërmarrje të vogla të sapokrijuara nga sipërmarrëset femra

1. Skemat e ndihmës shtetërore në favor të ndërmarrjeve të vogla të krijuara nga sipërmarrëse femra lejohen nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotësojnë kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Përfitues të kësaj ndihme janë ndërmarrjet e vogla të sapokrijuara nga sipërmarrëset femra.

3. Shuma e ndihmës nuk duhet të kalojë 1 milion euro për çdo ndërmarrje. Shuma vjetore e ndihmës nuk duhet të kalojë 33% të kësaj shume.

4. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 15% të kostove të pranueshme të shkaktuara gjatë 5 viteve të para të krijimit të ndërmarrjes.

5. Kostot e pranueshme duhet të jenë kosto për shërbime ligjore, konsulencë dhe administrative, të lidhura drejtpërdrejt me krijimin e ndërmarrjeve të vogla, si edhe kostot e mëposhtme, për sa kohë që ato janë shkaktuar në 5 vitet e para të krijimit të ndërmarrjes:

a) Interesi mbi një financim të jashtëm dhe dividendët në kapitalin e vet të përdorur nuk e kalojnë normën e referencës;

b) Tarifat për marrjen me qira të ndërtesave/pajisjeve të prodhimit;

c) Energjia, uji, ngrohja, taksat (përveç TVSH-së dhe taksave mbi të ardhurat e biznesit) dhe shpenzimet administrative;

ç) Amortizimi, tarifat për dhënien me qira të ndërtesave/pajisjeve të prodhimit, si dhe shpenzimet e pagave, me kusht që investimet themelore ose masat e krijimit të vendeve të punës dhe të rekrutimit të mos kenë përfituar nga ndihma të tjera;

d) Kujdesi për fëmijët dhe shpenzimet e kujdesit prindëror, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, shpenzimet që lidhen me lejen prindërore.



6. Ndërmarrjet e vogla të kontrolluara nga aksionarët e ndërmarrjeve që janë mbyllur në 12 muajt e fundit nuk mund të përfitojnë nga ndihma sipas këtij neni, nëse ndërmarrjet në fjalë janë aktive në të njëjtin treg përkatës ose në tregjet e afërta.

Neni 13

Ndihma për këshillim në favor të NVM-së

1. Ndihma për këshillim në favor të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme lejohet nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Intensiteti i ndihmës nuk tejkalon 50% të kostove të pranueshme.

3. Kostot e pranueshme janë ato të shërbimit të këshillimit të siguruara nga konsulentë të jashtëm.

4. Shërbimet përkatëse nuk duhet të jenë një aktivitet i vazhdueshëm ose periodik dhe as nuk duhet të jenë të lidhura me kostot e zakonshme operacionale të ndërmarrjes, si shërbimet e rregullta për këshillim tatimor, ligjor ose promovuese.

Neni 14

Ndihma për pjesëmarrje në panaire

1. Ndihma për pjesëmarrjen në panaire për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme lejohet nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot për qiranë, ngritjen dhe organizimin e standave për pjesëmarrjen e një ndërmarrjeje në një panair apo ekspozitë të caktuar.

3. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme.

Neni 15

Ndihma për riskun financiar

1. Ndihma për riskun financiar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme lejohet nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma shtetërore në formën e riskut financiar mund t'u jepet vetëm ndërmarrjeve të

vogla dhe të mesme, në formën e skemave të ndihmës shtetërore, me qëllim eliminimin e defekteve të tregut në tregjet e kapitalit financiar.

3. Ndihma shtetërore në formën e riskut financiar nuk mund t'u jepet ndërmarrjeve në vështirësi ose ndërmarrjeve në sektorin e qymyrit dhe çelikut.

4. Ndërmarrje përfituese janë ato ndërmarrje, të cilat, në kohën e investimit fillestar për financimin e riskut, janë NVM të paregjistruara dhe plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) Nuk kanë operuar në asnjë treg;

b) Kanë qenë duke operuar në treg për më pak se 7 vjet nga shitja e tyre e parë në kushtet e tregut;

c) Kanë nevojë për një investim fillestar për riskun financiar, i cili, në bazë të një plani biznesi të përgatitur në kuadër të hedhjes së një produkti të ri ose të hyrjes në një treg të ri gjeografik, është më i lartë se 50% e xhiros së tyre mesatare vjetore gjatë 5 viteve të fundit.

5. Ndihma për financimin e riskut mund të mbulojë edhe investimet shtesë që janë bërë për ndërmarrjet përfituese, përfshirë edhe ato pas periudhës 7-vjeçare të përmendura më lart në shkronjën "b", të pikës 4, të këtij neni, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Shuma totale e riskut financiar prej 15 milionë eurosh nuk tejkalohet;

b) Investimet shtesë janë parashikuar në planin fillestar të biznesit;

c) Ndërmarrja që ka marrë investime të mëtejshme nuk ka arritur të lidhet me një ndërmarrje tjetër, të ndryshme nga ndërmjetësi financiar ose investitori i pavarur privat, që siguron ndihmë për financimin e riskut sipas skemës, përveç rastit kur entiteti i ri ka plotësuar kriteret e përkufizimit të NVM-së.

6. Ndihma shtetërore për financimin e riskut duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Ndihma duhet të jetë pjesë e një fondi privat investimesh kapitali, i cili ka qëllim të nxjerrë fitim dhe që drejtohet mbi baza tregtare;

b) Ndihma nuk duhet të kalojë 1.5 milionë euro për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për një periudhë 1-vjeçare;

c) Fondi i investimeve siguron të paktën 70% të buxhetit total të investuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në formën e aksioneve apo instrumenteve të ngjashme;



c) Të paktën 50% e financimit të fondit të investimit do të sigurohet nga investitorët privatë. Në rastin e ndërmarrjeve në zonat e asistuara, të paktën 30% të burimeve të fondit të investimit duhet të sigurohen nga investitorët privatë;

d) Ndihma për investime për riskun financiar duhet të çojë në një rritje neto të kapitalit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në veçanti në rritjen e investimit nga investitorët privatë.

Neni 16

Kushtet e ndihmës për riskun financiar

1. Ndihma shtetërore për riskun financiar është në formën e pjesëmarrjes në një fond fitimprurës privat investimesh, i menaxhuar në kushtet e tregut.

2. Këstet, që u jepen ndërmarrjeve përfituese nga fondi i investimit gjatë një periudhe prej 12 muajsh, nuk duhet të kalojnë vlerën 200 000 (dyqind mijë) euro.

3. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat e asistuara, si edhe për ndërmarrjet e vogla të vendosura në zona jo të asistuara, masat për kapitalin e riskut kufizohen vetëm në ofrimin e kapitalit bazë, kapitalit themeltar dhe/ose për zgjerimin e kapitalit.

4. Fondi i investimeve duhet të sigurojë të paktën 70% të buxhetit të tij total të investuar në ndërmarrjen e vogël dhe të mesme në formën e kapitalit ose pjesëmarrjes në kapital.

5. Të paktën 50% të financimit të fondeve të investimeve duhet të sigurohet nga investitorë privatë. Në rastin e fondeve të investimit, që janë ekskluzivisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të vendosura në zonat e asistuara, të paktën 30% e financimit duhet të sigurohet nga investitorët privatë.

6. Për të siguruar që ndihma për riskun financiar është fitimprurëse, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Të eksiztojë një plan biznesi për çdo investim, i cili duhet të përmbajë detaje për prodhimin, shitjet dhe zhvillimin e rentabilitetit dhe vendosjen *ex-ante* e qëndrueshmërisë së projektit; dhe

b) Një strategji të qartë dhe realiste për daljen nga çdo investim.

7. Për të siguruar që fondi i investimeve është drejtuar mbi baza tregtare, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Duhet të ketë një marrëveshje midis një menaxheri profesionist të fondeve dhe pjesëmarrësve në fond, ku shpërblimi i menaxherit lidhet me performancën, përcaktimin e objektivave për fondin dhe të kohës së propozuar të investimit;

b) Investitorët privatë do të përfaqësohen në vendimmarrje nëpërmjet një komiteti investitorësh apo këshilltarësh; dhe

c) Praktikrat më të mira dhe mbikëqyrja rregullatore duhet të zbatohen për menaxhimin e fondit.

Neni 17

Ndihma për ndërmarrjet e sapokrijuara

1. Skemat e ndihmës shtetërore për ndërmarrjet e sapokrijuara lejohen nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, nëse plotësojnë kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndërmarrje përfituese mund të jetë vetëm një ndërmarrje e vogël e palistuar për 5 vjet nga themelimi i saj, e cila nuk ka shpërndarë ende përfitimet dhe nuk është krijuar nëpërmjet një shkrirjeje. Për ndërmarrjet që nuk janë objekt i regjistrimit, periudha e pranueshme prej 5 vjetësh mund të konsiderohet si momenti fillestar kur ndërmarrja ose fillon aktivitetin e saj ekonomik, ose do t'u nënshtrohet tatimeve mbi aktivitetin e saj ekonomik.

3. Ndihma fillestare duhet të jetë:

a) Në formën e huave me norma interesi, të cilat nuk janë në përputhje me kushtet e tregut, për një afat 10-vjeçar dhe deri në një shumë maksimale nominale prej 1 milion eurosh ose 1,5 milionë eurosh për ndërmarrjet e themeluara në zonat e asistuara që i plotësojnë kushtet e nenit 13(c), të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", ose 2 milionë euro për ndërmarrjet e themeluara në zonat e asistuara, që i plotësojnë kushtet e nenit 13(a) të këtij ligji. Për huat 5- ose 10-vjeçare, shuma maksimale mund të ndryshohet, duke shumëzuar shumën e sipërme në raport me afatin 10-vjeçar dhe aktual të huas. Për huat me afat më pak se 5 vjet, shuma maksimale është e njëjtë si për huat 5-vjeçare;

b) Shuma e garancive me prime, që nuk janë në përputhje me kushtet e tregut, për një afat 10-vjeçar dhe maksimumi deri në 1,5 milionë euro të shumës së garantuar, ose 2,25 milionë euro për



ndërmarrjet e themeluara në zonat e asistuara, që i plotësojnë kushtet e nenit 13(c) të ligjit për ndihmën shtetërore, ose 3 milionë euro për ndërmarrjet e themeluara në zonat e asistuara që i plotësojnë kushtet e nenit 13(a) të këtij ligji. Për garancitë me afat nga 5 deri në 10 vjet shuma maksimale e garantuar mund të ndryshohet duke shumëzuar shumat e mësipërme në raport me afatin 10-vjeçar dhe atë aktual të garancisë. Për garancitë me afat më pak se 5 vjet, shuma maksimale e garantuar do të jetë e njëjtë ashtu si për garancitë me afat 5-vjeçar. Garancia nuk do të tejkalojë 80% të huas bazë;

c) Grantet, përfshirë investimet e kapitalit ose pjesëmarrjen në kapital, reduktimin e normës së interesit dc) he reduktimin e shumës së primeve deri në 0,04 milionë euro të ekuivalentit bruto të grantit ose 0,6 milionë euro për ndërmarrjet e themeluara në zonat e asistuara që i plotësojnë kushtet e nenit 13(c), të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, ose 0,8 milionë euro për ndërmarrjet e themeluara në zonat e asistuara që i plotësojnë kushtet e nenit 13(a) të këtij ligji.

4. Një përfitues mund të marrë mbështetje me anë të një kombinimi të instrumenteve të ndihmës të referuara në pikën 3 të këtij neni, me kusht që pjesa e shumës së dhënë, nëpërmjet një instrumenti të vetëm të ndihmës, të përlogaritur mbi bazë të shumës maksimale të ndihmës së lejuar për atë instrument, të marrë në konsideratë pjesën e mbetur të shumës maksimale të ndihmës së lejuar për instrumente të tjera, të cilat janë pjesë të një instrumenti të tillë të kombinuar.

5. Për ndërmarrje të vogla dhe novatore, shumat maksimale të përcaktuara në pikën 3 mund të dyfishohen.

SEKSIONI II NDIHMA PËR PUNËSIMIN E PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NË VËSHITRËSI DHE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Neni 18

Ndihma për punësimin e punëkërkuesve të papunë në vështirësi në formën e subvencionit të pagës

1. Ndihma shtetërore për punësimin e punëkërkuesve të papunë në vështirësi në formën

e subvencionit lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme janë në formën e kostove të pagave gjatë një periudhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga momenti i rekrutimit të një punonjësi në kushte të pafavorshme. Në rastin kur punonjësi është në kushte mjaft të vështira, kostot e pranueshme janë në formën e kostove të pagave për një periudhë maksimale prej 24 (njëzet e katër) muaj pas marrjes në punë.

3. Në rastin kur punësimi nuk përfaqëson një rritje neto të numrit të të punësuarve në ndërmarrjen përfituese, në krahasim me mesataren gjatë 12 muajve të mëparshëm, vendi ose vendet e punës konsiderohen të lëna vakant si rezultat i largimit vullnetar, për arsye të aftësive të kufizuara, daljes në pension në bazë të moshës, reduktimit vullnetar të orëve të punës ose të largimit të ligjshëm nga puna dhe jo si rezultat i shkurtimit të vendeve të punës.

4. Me përjashtim të rasteve të shkarkimit të ligjshëm nga puna, punonjësit në kushte të pafavorshme kanë të drejtën e punësimit të vazhdueshëm për një periudhë minimale, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose me marrëveshjet kolektive që rregullojnë kontratat e punësimit.

5. Nëse periudha e punësimit është më e shkurtër se 12 muaj, ose 24 muaj në rastin e punonjësve në kushte jashtëzakonisht të vështira, ndihma reduktohet proporcionalisht në përputhje me rrethanat.

6. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme.

Neni 19

Ndihma për punësimin e punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara në formën e subvencionit të pagës

1. Ndihma shtetërore për punësimin e punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara në formën e subvencionit të pagës lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme duhet të jenë në formën e kostove të pagave për çdo periudhë, gjatë së cilës është punësuar punonjësi me aftësi të kufizuara.



3. Në rastin kur punësimi nuk përfaqëson një rritje neto të numrit të të punësuarve në ndërmarrjen përfituese, në krahasim me mesataren gjatë 12 muajve të mëparshëm, vendi ose vendet e punës konsiderohen të lëna vakant si rezultat i largimit vullnetar, për arsye të aftësive të kufizuara, daljes në pension në bazë të moshës, reduktimit vullnetar të orëve të punës ose të largimit të ligjshëm nga puna dhe jo si rezultat i shkurtimit të vendeve të punës.

4. Me përjashtim të rasteve të një shkarkimi të ligjshëm, punonjësit me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e punësimit të vazhdueshëm për një periudhë minimale në përputhje me legjislacionin në fuqi ose me marrëveshjet kolektive ligjërish të detyrueshme për ndërmarrjen dhe kontratave të punësimit që i rregullojnë ato.

5. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 75% të kostove të pranueshme.

Neni 20

Ndihma për kompensimin e kostove shtesë të punësimit të personave me aftësi të kufizuara

1. Ndihma shtetërore për kompensimin e kostove shtesë të punësimit të personave me aftësi të kufizuara lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme janë në formën e:

a) Kostove për përshtatjen e ambienteve;

b) Kostove për punësimin e stafit vetëm për kohën e shpenzuar në mbështetje të punonjësve me aftësi të kufizuara dhe për trajnimin e stafit që duhet të asistojë punonjësit me aftësi të kufizuara;

c) Kostove të përshtatjes ose blerjes së pajisjeve, ose kontrollit dhe vlerësimit të programeve *software* për përdorim nga punonjësit me aftësi të kufizuara, përfshirë pajisje teknologjike të përshtatshme dhe ndihmëse, që i tejkalojnë kostot që përfituesi do t'i kishte përdorur nëse do të kishte punësuar punonjës që nuk janë me aftësi të kufizuara.

ç) Kostove të lidhura drejtpërsëdrejti me transportin e punonjësve me aftësi të kufizuara drejt vendit të punës ose ambienteve përkatëse;

d) Kostove të pagave për orët e shpenzuara të rehabilitimit nga një punonjës me aftësi të kufizuara;

dh) Në rastin kur përfituesi siguron ambiente pune të përshtatshme, kostot e ndërtimit,

instalimit ose modernizimit të njësive prodhuese të ndërmarrjes përfituese, dhe çdo kosto që përfshin administrimin dhe transportin, me kusht që kosto të tilla të rezultojnë drejtpërsëdrejti nga punësimi i punonjësve me aftësi të kufizuara.

3. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 100% të kostove të pranueshme.

Neni 21

Ndihma për kompensimin e kostove të asistencës së ofruar për punonjësit e grupeve të disavantazuara

1. Ndihma shtetërore për kompensimin e kostove të asistencës së ofruar për punonjësit në kushte të pafavorshme lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme përfshijnë kostot për:

a) Punësimin e stafit vetëm për kohën e shpenzuar për të ndihmuar punonjësit në kushte të pafavorshme, për një periudhë kohe jo më shumë se 12 muaj, pas marrjes në punë të punonjësit në kushte të pafavorshme ose për një periudhë kohe jo më shumë se 24 muaj pas marrjes në punë të punonjësit në kushte mjaft të pafavorshme;

b) Trajnimin e stafit për të ndihmuar punonjësit në kushte të pafavorshme.

3. Ndihma e ofruar përbëhet nga masat për të mbështetur autonominë e punonjësit në kushte të pafavorshme dhe përshtatjen me mjedisin e punës, për shoqërimin e punonjësit gjatë procedurave sociale dhe administrative, lehtësimin e komunikimit me sipërmarrësin dhe menaxhimin e konflikteve.

4. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme.

SEKSIONI III NDIHMA PËR TRAJNIM

Neni 22

Ndihma për trajnim

1. Ndihma për trajnim lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma për trajnim nuk jepet për të siguruar që ndërmarrjet të kryejnë trajnime në përputhje me standardet e detyrueshme kombëtare.



3. Kostot e pranueshme janë, si më poshtë vijon:

a) Kostot për trajnimin e personelit për orët gjatë të cilave trajnerët marrin pjesë;

b) Kostot operacionale të trajnerëve dhe të të trajnuarve që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me trajnimin, si: shpenzimet e udhëtimit, materialet ose furnizimet e lidhura drejtpërsëdrejti me projektin, amortizimi i mjeteve dhe i pajisjeve deri në atë masë që të jenë përdorur vetëm për projektin e trajnimit. Kostot për akomodimin nuk përfshihen, me përjashtim të rastit të kostove minimale të akomodimit, të nevojshme për të trajnuarit që janë punonjës me aftësi të kufizuara;

c) Kostot e shërbimeve të këshillimit, që kanë të bëjnë me projektin e trajnimit;

ç) Kostot e personelit të të trajnuarve dhe kostot e përgjithshme indirekte (kostot administrative, qiraja, kostot e përgjithshme) për orët gjatë të cilave të trajnuarit marrin pjesë.

4. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme. Ai mund të rritet deri në intensitetin maksimal prej 70% të kostove të pranueshme, si më poshtë vijon:

a) Me 10 pikë përqindjeje, nëse trajnimi u ofrohet punonjësve me aftësi të kufizuara ose në kushte të pafavorshme;

b) Me 10 pikë përqindjeje, nëse ndihma u jepet ndërmarrjeve të mesme dhe me 20 pikë përqindjeje, nëse ajo u jepet ndërmarrjeve të vogla.

5. Në rastin kur ndihma jepet për sektorin e transportit detar, intensiteti i ndihmës mund të rritet me 100% të kostove të pranueshme, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Të trajnuarit nuk janë anëtarë aktivë të ekuipazhit, por zëvendësues të përkohshëm; dhe

b) Trajnimi të kryhet në bordin e anijeve të listuara në regjistrat e vendit.

SEKSIONI IV

NDIHMA PËR KËRKIM, ZHVILLIM DHE INOVACION

Neni 23

Ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion

1. Ndihma për kërkim, zhvillim dhe inovacion mund t'u jepet ndërmarrjeve në çdo sektor, përveç ndërmarrjeve në vështirësi.

Faqe | 9088

2. Në rastet kur një ndihmë e tillë u jepet ndërmarrjeve të mëdha, këto ndërmarrje duhet të provojnë efektin nxitës të ndihmës për sa u përket: rritjes së volumit të projektit, zgjerimit të fushës së aktivitetit, zbatimit më të shpejtë të projektit dhe rritjes së shumës totale për kërkim, zhvillim dhe inovacion.

Neni 24

Ndihma për projektet e kërkimit dhe zhvillimit

1. Ndihma për projektet e kërkimit dhe zhvillimit lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Pjesa e subvencionuar e projektit të kërkimit dhe zhvillimit duhet t'i përkasë tërësisht një ose më shumë kategorive të mëposhtme:

a) Kërkimit themelor;

b) Kërkimit industrial;

c) Zhvillimit eksperimental;

ç) Studimit të fizibilitetit.

3. Kostot e pranueshme për projektet e kërkimit dhe zhvillimit duhet të shpërndahen për një kategori të caktuar të kërkimit dhe zhvillimit, si më poshtë vijon:

a) Kostot për stafin: studiuesit, teknikët dhe stafi tjetër mbështetës të punësuar në projekt;

b) Kostot për mjetet dhe pajisjet deri në atë masë dhe gjatë periudhës që përdoren për projektin. Në rastin kur mjetet dhe pajisjet nuk përdoren për gjithë ciklin e tyre të jetës gjatë periudhës së projektit, të pranueshme janë vetëm kostot e amortizimit, që korrespondojnë me jetëgjatësinë e projektit, të përlogaritura në bazë të parimeve përgjithësisht të pranura të kontabilitetit;

c) Kostot për ndërtesat dhe tokën deri në atë masë dhe për periudhën e përdorur për projektin. Për sa u përket ndërtesave, janë të pranueshme vetëm kostot e amortizimit, që korrespondojnë me jetëgjatësinë e projektit, të përlogaritura në bazë të parimeve përgjithësisht të pranura të kontabilitetit. Në lidhje me tokën, kostot për transferimin tregtar ose kostot e përdorura të kapitalit janë të pranueshme;

ç) Kostot e kërkimit kontraktual, njohurive dhe patentave, të blera ose të licencuara nga burime të jashtme në kushte normale tregu, si dhe kostot për këshillim e shërbime ekuivalente të përdorura vetëm për projektin;



d) Kostot shtesë të përgjithshme ose kosto të tjera operacionale, përfshirë kostot për materialet, furnizimet e produktet e ngjashme, si shpenzime të drejtpërdrejta të projektit.

4. Kostot e pranueshme për studimet e fizibilitetit janë kostot e studimit.

5. Intensiteti i ndihmës për çdo përfitues nuk duhet të tejkalojë:

a) 100% të kostove të pranueshme për kërkimet themelore;

b) 50% të kostove të pranueshme për kërkimet industriale;

c) 25% të kostove të pranueshme për zhvillimet eksperimentale;

ç) 50% të kostove të pranueshme për studimet e fizibilitetit.

6. Intensiteti i ndihmës për kërkimet industriale dhe zhvillimet eksperimentale mund të rritet maksimalisht deri në 89% të kostove të pranueshme, si më poshtë vijon:

a) Me 10 pikë përqindjeje për ndërmarrjet e mesme dhe me 20 pikë përqindjeje për ndërmarrjet e vogla;

b) Me 15 pikë përqindjeje, nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

i. Projekti përfshin bashkëpunimin efektiv ndërmjet një ndërmarrjeje dhe një ose më shumë organizatave kërkimore dhe transferimit të njohurive, ku këto të fundit bartin të paktën 10% të kostove të pranueshme dhe zotërojnë të drejtën për të publikuar rezultatet e tyre kërkimore;

ii. Rezultatet e projektit shpërndahen gjerësisht me anë të konferencave, publikimeve, qendrave të aksesueshme për ruajtjen e informacionit ose programeve falas dhe të aksesueshme kompjuterike.

7. Intensiteti i ndihmës për studimet e fizibilitetit mund të rritet me 10 pikë përqindjeje për ndërmarrjet e mesme dhe me 20 pikë përqindjeje për ndërmarrjet e vogla.

Neni 25

Ndihma për investime në infrastrukturën e projekteve kërkimore shkencore

1. Ndihma shtetërore për investime në infrastrukturën e projekteve kërkimore shkencore lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kur një infrastrukturë kërkimi zhvillon si aktivitete ekonomike, ashtu dhe joekonomike, financimi, kostot dhe të ardhurat e çdo aktiviteti duhet të kontabilizohen veçmas, mbi bazën e parimeve të kontabilitetit, të zbatuara me koherencë dhe objektivisht të justifikuara.

3. Vlera e caktuar për funksionimin ose përdorimin e infrastrukturës duhet të korrespondojë me çmimin e tregut.

4. Aksesit në infrastrukturë duhet të jetë i hapur për shumë përdorues dhe duhet të ofrohet në mënyrë transparente dhe të paanshme. Ndërmarrjeve, që kanë financuar 10% të kostove të investimit në infrastrukturë, mund t'u ofrohet akses preferencial në kushte më të favorshme. Me qëllimin e shmangies së mbikompensimit, një akses i tillë duhet të jetë proporcional me kontributin e ndërmarrjes për kostot e investimit dhe këto kushte duhet të jenë të disponueshme për publikun.

5. Kostot e pranueshme janë kostot e investimit në asete të prekshme dhe të paprekshme.

6. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme.

7. Në rastin ku një infrastrukturë kërkimi merr fonde publike si për aktivitete ekonomike dhe joekonomike, duhet të vendoset një mekanizëm monitorimi dhe rikuperimi, për të siguruar që intensiteti i ndihmës së zbatuar të mos tejkalohet si rezultat i rritjes së pjesës së aktiviteteve ekonomike, krahasuar me situatën e parashikuar në momentin e dhënies së ndihmës.

Neni 26

Ndihma për klasterat e inovacionit

1. Ndihma për klasterat e inovacionit lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma për klasterat e inovacionit u jepet vetëm subjekteve juridike, të cilat kontrollojnë funksionimin e tyre.

3. Aksesit në ambientet e klasterave, pajisjet dhe aktivitetet e klasterave u ofrohen përdoruesve të ndryshëm, në mënyrë transparente dhe të paanshme. Ndërmarrjet, që kanë financuar të paktën 10% të kostove të investimit të klasterave të inovacionit, mund t'u ofrohet akses preferencial me kushte më të favorshme. Me qëllim shmangien e



mbikompensimit, një akses i tillë duhet të jetë proporcional në raport me kontributin e ndërmarrjes për kostot e investimit dhe kushte të tilla duhet të bëhen publike.

4. Tarifat e paguara për përdorimin ambienteve të klasterave dhe për pjesëmarrjen në aktivitetet e tyre duhet të korrespondojnë me çmimin e tregut ose të reflektojnë kostot përkatëse.

5. Ndihma për investim mund të jepet për ndërtimin ose përmirësimin e klasterave të inovacionit. Kostot e pranueshme janë kostot e investimit në asete të prekshme dhe të paprekshme.

6. Intensiteti i ndihmës për investim për klasterat e inovacionit nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 10 pikë përqindjeje për klasterat, që ndodhen në zonat e asistuara që plotësojnë kushtet e nenit 13(a), të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, dhe me 5 pikë përqindjeje për klasterat e inovacionit në zonat e asistuara që plotësojnë kushtet e nenit 13(c) të këtij ligji.

7. Ndihma operationale mund të jepet për funksionimin e klasterave të inovacionit, për një periudhë jo më të gjatë se 10 vjet.

8. Kostot e pranueshme të ndihmës operationale për klasterat e inovacionit janë kostot për personelin dhe kostot administrative, përfshirë kostot e përgjithshme, lidhur me:

a) Animacionin e klasterit për të lehtësuar bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe sigurimin ose ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe të personalizuara në mbështetje të aktivitetit tregtar;

b) Aktivitetin e marketingut të qendrës për të rritur pjesëmarrjen e ndërmarrjeve ose organizatave të reja dhe për të shtuar vizibilitetin e qendrës;

c) Menaxhimin e fasileve/ambienteve të qendrës, organizimin e programeve të trajnimit, seminareve dhe konferencave për të mbështetur zhvillimin dhe shkëmbimin e njohurive dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

9. Intensiteti i ndihmës operationale nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove totale të pranueshme gjatë periudhës në të cilën është dhënë ndihma.

Neni 27

Ndihmë për nxitjen e projekteve të inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

1. Ndihma për nxitjen e projekteve të inovacionit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme janë, si më poshtë vijon:

a) Kostot për zotërimin, vërtetimin dhe mbrojtjen e patentave dhe të aseteve të tjera të paprekshme;

b) Kostot për vënien në dispozicion të personelit me kualifikim të lartë nga një organizatë kërkimi ose nga një ndërmarrje e madhe, e cila kryen aktivitete kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni, në një funksion të krijuar rishtazi brenda ndërmarrjes përfituese, pa zëvendësuar pjesëtarët e tjerë të stafit;

c) Kostot për këshillimet e inovacionit dhe shërbimet mbështetëse;

3. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme.

4. Në rastet e ndihmës së dhënë për këshillimet e inovacionit dhe shërbimet mbështetëse, intensiteti i ndihmës mund të rritet me 100% të kostove të pranueshme, me kusht që shuma totale e ndihmës për këshillimet e inovacionit dhe shërbimet mbështetëse të mos tejkalojë shumën për 200 000 (dyqind mijë) euro për çdo ndërmarrje për një periudhë trevjeçare.

SEKSIONI V

NDIHMA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 28

Ndihma për investime për eficiencën dhe kursimin e energjisë

1. Ndihma për investim që u jep mundësi ndërmarrjeve të arrijnë një eficiencë të energjisë lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme për ndihmën në investime për eficiencën e energjisë janë kostot shtesë të investimeve, të nevojshme për të arritur nivelin më të lartë të eficiencës së energjisë:



a) Në rastin kur kostot e investimit për eficiencën e energjisë mund të identifikohen si një investim më vete në koston totale të investimit, kostot e lidhura me eficiencën e energjisë përbëjnë kostot e pranueshme;

b) Në të gjitha rastet e tjera, kostot e investimit për eficiencën e energjisë identifikohen duke referuar te një investim i ngjashëm, me më pak eficiencë energjie, që do të ishte kryer në mungesë të ndihmës. Ndryshimi midis kostove të të dyja investimeve konsiderohet kosto e lidhur me eficiencën e energjisë dhe përbën kostot e pranueshme.

Kostot që nuk lidhen drejtpërdrejt me arritjen e një niveli më të lartë të eficiencës së energjisë nuk konsiderohen kosto të pranueshme.

3. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 30% të kostove të pranueshme.

4. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 20 pikë përqindjeje për ndihmën e dhënë për ndërmarrjet e vogla dhe me 10 pikë përqindjeje për ndihmën e dhënë për ndërmarrjet e mesme.

5. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 15 pikë përqindjeje për investimet e kryera në zonat e asistuara që plotësojnë kushtet e nenit 13(a), të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, dhe me 5 pikë përqindjeje për investimet e kryera në zonat e asistuara që plotësojnë kushtet e nenit 13(c), të këtij ligji.

Neni 29

Ndihma për investim për prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme

1. Ndihma për investim për promovimin e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma për investim për prodhimin e biokarburanteve, sipas këtij neni, lejohet vetëm në atë masë që investimet e subvencionuara përdoren për prodhimin e biokarburanteve të qëndrueshme, me përjashtim të atyre që janë me bazë ushqimore. Ndihma për investim për konvertimin e impianteve të biokarburanteve me baza ushqimore në impiante të avancuara është e lejueshme, sipas këtij neni, me kusht që prodhimi me bazë ushqimore reduktohet në përpjesëtim me kapacitetin e ri.

3. Ndihma nuk jepet për biokarburantet që janë subjekte të një detyrimi furnizimi apo përzierjeje.

4. Ndihma për investim jepet vetëm për impiantet e reja. Asnjë ndihmë nuk mund të jepet ose kompensohet pas vënies në funksion të impiantit dhe ndihma duhet të jetë e pavarur nga prodhimi.

5. Kostot e pranueshme janë kostot shtesë të investimeve të nevojshme për promovimin e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme. Ato përcaktohen, si më poshtë vijon:

a) Në rastin kur kostot e investimit në prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme mund të identifikohen si investim më vete në koston totale të investimit, kjo kosto e energjisë së rinovueshme përbën kostot e pranueshme;

b) Në rastin kur kostot e investimit në prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme mund të identifikohen duke iu referuar një investim të ngjashëm më pak miqësor ndaj mjedisit, që do të ishte kryer në mungesë të ndihmës, ndryshimi midis kostove të të dy investimeve përbën kostot e lidhura me energjinë e rinovueshme dhe përbën kostot e pranueshme.

c) Për impiante të vogla të caktuara, ku nuk mund të përcaktohet një investim më pak miqësor ndaj mjedisit, duke qenë se impiantet e një përmase të tillë nuk ekzistojnë, kostot e pranueshme janë kostot totale të investimit për të arritur një nivel më të lartë të mbrojtjes së mjedisit. Kostot, të cilat nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me arritjen e një niveli më të lartë për mbrojtjen e mjedisit, nuk janë të pranueshme.

6. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë:

a) 45% të kostove të pranueshme, nëse këto kosto janë përlogaritur në bazë të pikave 5 (a) ose 5 (b) të këtij neni;

b) 30% e kostove të pranueshme nëse këto kosto janë përlogaritur në bazë të pikës 5 (c) të këtij neni.

7. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 20 pikë përqindjeje për ndihmën e dhënë për ndërmarrjet e vogla dhe me 10 pikë përqindjeje për ndihmën e dhënë për ndërmarrjet e mesme.

8. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 20 pikë përqindjeje për investimet që ndodhen në zonat e asistuara që plotësojnë kushtet e nenit 13(a), të ligjit “Për ndihmën shtetërore”, dhe me



5 pikë përqindjeje për investimet në zonat e asistuara që plotësojnë kushtet e nenit 13(c) të ligjit. Një proces i tillë tenderimi duhet të jetë i paanshëm dhe i hapur për të gjitha palët e interesuara.

9. Kur ndihma shtetërore jepet nëpërmjet një procedure konkurruese prokurimi, mbi bazën e kriterëve të qarta, transparente dhe jodiskriminuese, intensiteti i ndihmës mund të arrijë në 100% të kostove të pranueshme. Një proces i tillë prokurimi, duhet të jetë jodiskriminues dhe i hapur për pjesëmarrjen e të gjitha ndërmarrjeve të interesuara. Buxheti i lidhur me procesin e prokurimit përbën kufizim të detyrueshëm, në kuptimin që jo të gjithë pjesëmarrësit mund të përfitojnë nga ndihma dhe ndihma jepet mbi bazën e ofertës fillestare të paraqitur nga ofertuesi, duke i përjashtuar negociatat e mëtejshme.

Neni 30

Ndihma operationale për promovimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme

1. Ndihamat operationale për promovimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma operationale jepet sipas një procedure konkurruese, në bazë të kriterëve të qarta, transparente dhe të paanshme, e hapur për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

3. Procedura e prokurimit mund të kufizohet në kërkesa për teknologji specifike kur një procedurë e hapur për të gjithë prodhuesit do të çonte drejt një rezultati nën nivelin optimal në drejtim të:

- a) Potencialit afatgjatë të një teknologjie të re dhe novatore; ose
- b) Nevojës për diversifikim; ose
- c) Kufizimet e rrjetit dhe qëndrueshmërisë e tij; ose
- d) Kostove të sistemit të integritetit; ose
- e) Nevojës për të shmangur shtrembërimin në tregjet e lëndëve të para për shkak të mbështetjes në biomasë.

4. Ndihma jepet për teknologjitë e reja dhe novatore të energjisë së rinovueshme nëpërmjet

një procedure konkurruese, sipas kriterëve të qarta, transparente dhe të paanshme. Një ndihmë e tillë nuk jepet për më shumë se 5% të kapacitetit të ri të planifikuar për energjinë elektrike nga burime të energjisë së rinovueshme, për çdo vit në total.

5. Ndihma jepet si shtesë mbi çmimin e tregut, me të cilin prodhuesit e shesin energjinë elektrike drejtpërsëdrejti në treg.

6. Përfituesit e ndihmës duhet t'u nënshtrohen përgjegjësi standarde të balancimit. Përfituesit mund t'i transferojnë përgjegjësitë e balancimit drejt ndërmarrjeve të tjera në emër të tyre, si agregatorë.²

7. Ndihma nuk duhet të jepet kur çmimet janë në nivelin negativ.

8. Ndihma mund të jepet në mungesë të një procesi konkurrues për impiantet me një kapacitet të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike prej më pak se 1 mw nga burime të rinovueshme, me përjashtim të energjisë së erës, e cila mund të jepet edhe në mungesë të një procesi konkurrues për impiantet me një kapacitet të instaluar të energjisë elektrike prej më pak se 6 mw, ose për impiantet me më pak se 6 njësi prodhimi. Pa cenuar pikën 9, ku ndihma është dhënë në mungesë të një procesi konkurrues, duhet të respektohen kushtet e përshkruara në pikat 5, 6 e 7.

9. Kushtet e përshkruara në pikat 5, 6 e 7 nuk gjejnë zbatim për ndihmën operationale që i jepet impianteve me një kapacitet të instaluar për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme prej më pak se 50 kw, me përjashtim të energjisë së erës, për të cilën këto kushte nuk zbatohen për ndihmën operationale për impiantet me një kapacitet të instaluar për prodhimin e energjisë prej më pak se 3 mw, ose për impiantet me më pak se 3 njësi prodhimi.

10. Për qëllime të përlllogaritjes së kapaciteteve të mësipërme të referuara në pikat 8 e 9 të këtij neni, impiantet me një pikë lidhjeje të përbashkët me rrjetin e energjisë elektrike konsiderohet si një impiant i vetëm.

11. Ndihma jepet vetëm pasi impianti i prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e

² "Agregator", subjekt legal, i cili është përgjegjës për operimin e një numri pajisjesh të kërkesës.



rinovueshme të jetë plotësisht i amortizuar, në përputhje me parimet gjerësisht të pranuar të kontabilitetit. Çdo ndihmë për investim e pranuar më parë duhet të zbritet nga ndihma operationale.

Neni 31

Ndihma për investim për rehabilitimin e vendeve të ndotura

1. Ndihma për investim për rehabilitimin e vendeve të ndotura mund të lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma për investim për rehabilitimin e vendeve të ndotura synon rregullimin e dëmeve mjedisore, përfshirë dëmet ndaj cilësisë së dheut, ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore.

3. Në rastin kur personi fizik ose juridik është përgjegjës për dëmtimin e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ai duhet të financojë rehabilitimin, në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe për të nuk jepet asnjë ndihmë shtetërore. Nëse personi përgjegjës sipas ligjit nuk identifikohet ose nuk mbulon shpenzimet, personi përgjegjës për procesin e rehabilitimit dhe dezinfektimit mund të marrë ndihmë shtetërore.

4. Kostot e pranueshme janë shpenzimet e bëra për punimet e rehabilitimit minus rritjen e vlerës së tokës. Në rastin e rehabilitimit të zonave të ndotura, të gjitha shpenzimet e bëra nga një ndërmarrje për rehabilitimin e zonës së saj mund të konsiderohen si investime të pranueshme, pavarësisht faktit nëse një shpenzim i tillë mund të paraqitet si pjesë e një asemi të prekshëm në pasqyrat e saj financiare.

5. Vlerësimet e rritjes së vlerës së tokës si pasojë e rehabilitimit duhet të kryhen nga një ekspert i pavarur.

6. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 100% të kostove të pranueshme.

Neni 32

Ndihma për investim për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve

1. Ndihma për investim për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma për investim duhet të jepet për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të prodhuara nga ndërmarrje të tjera.

3. Materialet e ricikluara ose të ripërdorura janë materiale që, në mungesë të ndihmës, do të ishin asgjësuar ose të trajtuar në mënyrën më pak miqësore për mjedisin. Ky nen nuk zbatohet për operationet e rigjenerimit të mbetjeve.

4. Investimet nuk duhet të shtojnë kërkesën për materiale për t'u ricikluar pa rritur grumbullimin e këtyre materialeve.

5. Investimet duhet të shkojnë përtej teknologjisë së fjalës së fundit.

6. Kostot e pranueshme duhet të jenë kostot shtesë të investimeve, të nevojshme për të realizuar një investim që çon drejt riciklimit dhe ripërdorimit më të mirë dhe më efikas të mbetjeve, në krahasim me një proces tradicional të ripërdorimit dhe riciklimit me të njëjtin kapacitet, që mund të ishte ndërtuar në mungesë të ndihmës.

7. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 35% të kostove të pranueshme. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 20 pikë përqindjeje për ndihmën e dhënë ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe me 10 pikë përqindjeje për ndihmën e dhënë ndaj ndërmarrjeve të mesme.

8. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 15 pikë përqindjeje për investimet në zonat e asistuar që plotësojnë kushtet e nenit 13(a) të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, dhe me 5 pikë përqindjeje për investimet në zonat e asistuar që plotësojnë kushtet e nenit 13(c) të këtij ligji.

9. Ky nen nuk zbatohet për ndihmën për investim në lidhje me riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të vetë përfituesit.

Neni 33

Ndihma për investim për infrastrukturën e energjisë

1. Ndihma për investim për infrastrukturën energjetike lejohet nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kjo ndihmë jepet për infrastrukturën energjetike në zonat e asistuar.

3. Kostot e pranueshme janë kostot e investimit.

4. Shuma e ndihmës nuk duhet të tejkalojë diferencën ndërmjet kostove të pranueshme dhe të të ardhurave operative të investimit. Të ardhurat operative zbriten nga kostot e pranueshme *ex-ante* ose nëpërmjet një mekanizmi rikuperimi.



5. Ky nen nuk zbatohet për ndihmën për investimet në projektet e energjisë elektrike, gazit dhe infrastrukturës së naftës.

Neni 34

Ndihma për studime mjedisore

1. Ndihma për studime mjedisore lejohet nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore, nëse plotëson kushtet e këtij neni dhe të kreut II të kësaj rregulloreje.

2. Kostot e pranueshme janë kostot për studimet mjedisore.

3. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 50% të kostove të pranueshme.

4. Intensiteti i ndihmës mund të rritet me 20 pikë përqindjeje për studimet e kryera për ndërmarrjet e vogla dhe me 10 pikë përqindjeje për studimet e kryera për ndërmarrjet e mesme.

SEKSIONI VI

NDIHMA RAJONALE

Neni 35

Fusha e zbatimit

1. Ndihma shtetërore rajonale mund të jepet për:

a) Investime fillestare ose për krijimin e vendeve të reja të punës, që lidhen me një investim fillestar;

b) Kostot operacionale.

2. Ndihma shtetërore rajonale nuk jepet për:

a) Aktivitete në sektorin e çelikut, qymyrit, ndërtimit të anijeve, fibrave sintetike, transportit dhe infrastrukturës përkatëse, prodhimit, shpërndarjes dhe infrastrukturës së energjisë;

b) Aktivitetet turistike, infrastrukturën e brezit të gjerë të telekomunikacionit ose përpunimin e marketingun e produkteve bujqësore nuk konsiderohen të jenë të destinuara për sektorë të veçantë të aktivitetit ekonomik;

c) Ndihmën në formën e skemave, të cilat kompensojnë kostot e transportit të mallrave të prodhuara në rajonet më të thella ose në zonat më pak të populluara dhe e dhënë në favor:

i. të prodhimit, përpunimit dhe marketingut të produkteve bujqësore, peshkut dhe nënproduktet e tij;

ii. të transportit të mallrave nëpërmjet tubacioneve.

3. Ndërmarrjet në vështirësi nuk mund të përfitojnë ndihmë rajonale.

Neni 36

Ndihma rajonale për investime

1. Masat e ndihmës rajonale për investime lejohet në rast se plotësohen kushtet e përcaktuara në nenet 14–21 dhe në kreun II të kësaj rregulloreje.

2. Ndihma jepet për zonat e asistuara.

3. Për zonat e asistuara, që plotësojnë kushtet e nenit 13 (a), të ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, ndihma mund të jepet për një investim fillestar, pavarësisht përmasës së ndërmarrjes së përfituesit. Për këto zona, që plotësojnë kushtet e nenit 13 (c) të këtij ligji, ndihma mund t’u jepet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për çdo lloj investimi fillestar. Ndihma për ndërmarrjet e mëdha jepet vetëm për një investim fillestar në favor të një aktiviteti të ri ekonomik në zonën në fjalë.

4. Kostot e pranueshme janë, si më poshtë vijon:

a) Kostot e investimit në asete të prekshme dhe jo të prekshme;

b) Kostot e vlerësuara të pagave që rrjedhin nga krijimi i vendeve të punës si rezultat i investimit fillestar të përllogaritura gjatë një periudhe prej dy vjetësh; ose

c) Një kombinim i kostove (a) e (b) që nuk e kalon vlerën e (a) ose (b), cilësdo që ka vlerën më të madhe.

5. Intensiteti i ndihmës në ekuivalentin bruto të grantit nuk duhet të tejkalojë intensitetin maksimal të ndihmës në hartën rajonale, e cila është në fuqi në kohën e dhënies së ndihmës për zonën në fjalë.

6. Në rastin ku intensiteti i ndihmës është përllogaritur si një kombinim i kostos për investimet dhe kostos së pagave të parashikuara për hapjen e vendeve të reja të punës, intensiteti maksimal i ndihmës nuk duhet të tejkalojë shumën më të favorshme, që rezulton nga zbatimi i atij intensiteti, në bazë të kostove të investimit ose kostove të pagesave.

7. Përfituesi i ndihmës duhet të sigurojë një kontribut financiar në të paktën 25% të kostove të pranueshme, me anë të burimeve të veta ose financimit të jashtëm, duke përjashtuar çdo lloj forme të financimit publik.

8. Në rajonet më të thella një investim i kryer nga një ndërmarrje e vogël ose e mesme mund të



marrë një ndihmë me një intensitet maksimal mbi 75%. Në këto raste pjesa e mbetur sigurohet me anë të një kontributi financiar nga përfituesi i ndihmës.

Neni 37

Koha e investimit

1. Investimi duhet të ruhet në zonën përfituese për të paktën pesë vjet pas përfundimit të investimit ose të paktën tre vjet në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

2. Kjo nuk duhet ta pengojë zëvendësimin e impianteve ose pajisjeve, të cilat janë vjetruar ose prishur brenda kësaj periudhe, me kusht që aktiviteti ekonomik të ruhet në zonën në fjalë për periudhën përkatëse minimale.

Neni 38

Kostot e qirasë për asetet e prekshme

Kostot e qirasë për asetet e prekshme mund të merren në konsideratë, sipas kushteve të mëposhtme:

a) Për tokën dhe ndërtesat, qiraja për ndërmarrjet e mëdha duhet të vazhdojë për të paktën pesë vjet pas datës së pritshme të përfundimit të projektit të investimit ose për tre vjet në rastin e NVM-së;

b) Për impiantin ose makineritë, qiraja duhet të sigurohet në formën e financimit dhe duhet të përfshijë një kusht me anë të të cilit përfituesi i ndihmës duhet t'i blejë këto asete në përfundim të kushteve të kontratës.

Neni 39

Asetet e paprekshme në llogaritjen e kostove të investimit

1. Ndihma shtetërore rajonale për investimet në asete të paprekshme jepet nëse plotësohen këto kushte:

a) Asetet e paprekshme duhet të përdoren vetëm në ndërmarrjen që ka përfituar ndihmën;

b) Ato duhet të jenë të amortizueshme;

c) Ato duhet të blihen në përputhje me kushtet e tregut nga një palë e tretë që nuk ka lidhje me blerësin; dhe

ç) Ato duhet të përfshihen në asetet e ndërmarrjes që ka përfituar ndihmën dhe duhet të mbeten të lidhura me projektin për të cilin është dhënë ndihma për të paktën pesë ose tre vjet në rastin e NVM-së.

2. Për ndërmarrjet e mëdha, kostot e aseteve të paprekshme janë të pranueshme vetëm deri në masën 50% të kostove totale të pranueshme të investimit për investimin fillestar.

Neni 40

Llogaritja e kostos së pagave

Në rastin kur shuma e ndihmës rajonale përlllogaritet duke iu referuar kostove të parashikuara të pagave për vendet e reja të punës, zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) Projekti i investimit duhet të sjellë një rritje neto në numrin e punonjësve në ndërmarrjen në fjalë, në krahasim me numrin mesatar të punonjësve në 12 muajt e fundit. Në rast se një vend pune mbyllet gjatë kësaj periudhe, ai vend duhet të zbritet nga numri i vendeve të punës të krijuara gjatë asaj periudhe;

b) Çdo vend pune duhet të plotësohet brenda tri vjetëve nga përfundimi i punimeve; dhe

c) Çdo vend pune i krijuar, nëpërmjet investimit, duhet të mbetet në zonën në fjalë për një periudhë jo më pak se pesë vjet nga data e plotësimit të parë ose tri vjet në rastin e NVM-së.

Neni 41

Blerja e ndërmarrjeve ose aseteve

1. Në rastet e blerjes së një ndërmarrjeje, e cila është mbyllur apo që do të ishte mbyllur nëse nuk do ishte blerë, kosto të pranueshme janë kostot e blerjes së aseteve të asaj ndërmarrjeje në kushtet e tregut nga një palë e tretë.

2. Nëse një anëtar i familjes së pronarit të parë ose një punonjës merr në dorëzimin një ndërmarrje të vogël, atëherë kushti që këto asete të blihen nga një palë e tretë që nuk ka lidhje me blerësin, nuk do të zbatohet. Zotërimi i aksioneve nuk përbën investim fillestar.

3. Asetet e blera duhet të jenë të reja, përveç rastit kur ndihma jepet për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme apo për blerjen e ndërmarrjeve. Nëse ndihma është dhënë për zotërimin e aseteve para blerjes së tyre, kostot e këtyre aseteve do të zbriten nga kostot e pranueshme për blerjen e një ndërmarrjeje.

Neni 42

Ndryshimi themelor në procesin e prodhimit

Për ndihmën e dhënë për arsye të një ndryshimi themelor në procesin e prodhimit,



kostot e pranueshme duhet të tejkalojnë zhvlerësimin e aseteve të lidhura me aktivitetin, me qëllim modernizmin e tyre gjatë periudhës, që u paraprin tri viteve fiskale. Për ndihmën e dhënë në favor të ndryshimit të një ndërmarrjeje ekzistuese, kostot e pranueshme duhet të tejkalojnë të paktën 200% të vlerës së kapitalit të aseteve që janë ripërdorur, të regjistruara në vitin fiskal që i paraprin fillimit të punimeve.

Neni 43

Shuma e lejuar e ndihmës shtetërore

1. Shuma për ndihmën shtetërore rajonale të dhënë për ndërmarrje të mëdha është deri në 50% të kostove të pranueshme për investimet fillestare.

2. Shuma e ndihmës shtetërore për investimet rajonale në pikën 1 të këtij neni mund të rritet me 20% për ndërmarrjet e vogla dhe me 10% për ndërmarrjet e mesme. Kjo rritje nuk zbatohet për ndërmarrjet që veprojnë në sektorin e transportit apo për projektet e mëdha të investimeve në çdo sektor.

Neni 44

Skemat e ndihmës rajonale operacionale

1. Skemat e ndihmës rajonale operacionale mund të lejohen nëse ndihmojnë në kompensimin e:

a) Kostove shtesë të transportit të mallrave të prodhuara në zonat e pranueshme për ndihmë operacionale, si edhe kostot shtesë të transportit të mallrave të përpunuara më tej në këto zona, sipas kushteve të mëposhtme:

i. përfituesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre të prodhimit në këto zona;

ii. ndihma në mënyrë objektive përcaktohet paraprakisht në sasi, në bazë të një shume të caktuar ose në raport për çdo ton/kilometër ose në çdo njësi tjetër përkatëse;

iii. këto kosto shtesë për transportin e mallrave janë përlogaritur mbi bazë të lëvizjes së mallrave brenda kufirit kombëtar të vendit, duke përdorur mënyrat e ndryshme të transportit me kosto më të vogla për përfituesin. Vetëm për rajonet më të thella, kostot shtesë të transportit të mallrave të përpunuara më tej në këto zona mund t'i përfshijnë kostot e transportit të mallrave nga çdo vend të prodhimit të këtyre zonave.

b) Kostove shtesë operacionale, përveç kostove të transportit, të shkaktuara në rajone të thella si rezultat i drejtpërdrejtë i një ose më shumë mangësive të përhershme, me kusht që:

i. përfituesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik në një rajon të thellë;

ii. shuma vjetore e ndihmës për përfituesin sipas të gjitha skemave të ndihmës operacionale nuk e tejkalon:

- 15% të vlerës së shtuar bruto të krijuar për çdo vit nga përfituesi në rajonin më të thellë në fjalë; ose

- 25% të kostove vjetore të punës të shkaktuara nga përfituesi në rajonin më të thellë në fjalë; ose

- 10% të xhiros vjetore të përfituesit e realizuar në rajonin më të thellë në fjalë.

2. Intensiteti i ndihmës nuk duhet të tejkalojë 100% të kostove shtesë të pranueshme siç përcaktohet në këtë dispozitë.



SHTOJCA I
INFORMACION LIDHUR ME KUSHTET E DHËNIES SË NDIHMËS SIPAS RREGULLORES
“PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT E DHËNIES DHE AUTORIZIMIT TË DISA
KATEGORIVE TË NDIHMËS SHETËTËRORE

PJESA I

Referenca e ndihmës	(të plotësohet nga Komisioni)	
Rajoni:	Emri i rajonit (NUTS) ³ :	Statusi i ndihmës rajonale ⁴
Dhënësi i ndihmës:	Emri:	
	Adresa postare: Adresa e faqes në internet:	
Periudha për të cilën jepet ndihma:		
Baza ligjore:		
Link-u i web-it me tekstin e plotë të masës shetëtorre:		
Lloji i masës shetëtorre:	Skemë ☐	
	Ndihmë <i>ad hoc</i> ☐	Emri i përfituesit dhe grupi ⁵ të cilit i përket
Amendime të një skeme ndihme ekzistuese ose një ndihme <i>ad hoc</i>		Referenca e Komisionit për Ndihmën
	Zgjatje	
	Ndryshime	
Kohëzgjatja ⁶	Skemë	dd/mm/vvvv deri dd/mm/vvvv
Data e dhënies	<i>Ad hoc</i>	dd/mm/vvvv
Sektori ekonomik	Të gjithë sektorët ekonomikë legjitimohen të marrin ndihmë	
	E kufizuar në disa sektorë	

Lloji i përfituesit	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	
	Ndërmarrje të mëdha	
Buxheti	Buxheti total vjetor i parashikuar në skemë ⁷	Monedha kombëtare
	Shumë e përgjithshme e ndihmës <i>ad hoc</i> të dhënë ndërmarrjes ⁸	Monedha kombëtare
	Garancitë	Monedha kombëtare
Instrumentet e ndihmës	Grante/ normë interesi për subvencionet	
	Kredi/parapagesa	
	Garanci ⁹	
	Avantazhe në taksat dhe përjashtime nga taksat	

³ NUTS- Nomenklatura e Njërive Territoriale për Statistika.

⁴ Neni 13(a) i ligjit për ndihmën shetëtorre “Status A”; neni 13(c) i ligjit për ndihmën shetëtorre “Status C”; zona që nuk janë të legjitimuara për të përfituar ndihmë shetëtorre rajonale “status N”.

⁵ Ndërmarrje është një person juridik që kryen veprimtari ekonomike, pavarësisht statusit ligjor dhe mënyrës së financimit.

⁶ Periudha në të cilën autoriteti që jep grantin angazhohet për të dhënë ndihmën.

⁷ Në rastin e një skeme të ndihmës shetëtorre, tregoni shumën e përgjithshme të buxhetit të planifikuar sipas skemës ose vlerësimin e humbjeve nga taksat për një vit për të gjitha instrumentet që përmban kjo skemë.

⁸ Në rastin e një skeme *ad hoc*, tregoni shumën e përgjithshme/humbjet nga taksat.

⁹ Për garancitë tregoni shumën (maksimale) të kredisë së garantuar.



	Parashikime për riskun financiar		
	Të tjera (ju lutem, specifikoni): Tregoni cilës kategori më poshtë ndihma e dhënë i përkon më mirë, për sa i përket funksionit/efektit Grant Kredi Garanci Avantazh në taksa Parashikim i riskut financiar		
Nëse bashkëfinancohet nga BE-ja	Emri i fondit	Shuma e financimit	Monedhë kombëtare

PJESA II

Objektivat kryesore- Objektivat e përgjithshme (listo)	Lista e objektivave		Intensiteti maksimal në % ose shuma maksimale e ndihmës në monedhën kombëtare	Bonuse të NVM në %
Ndihma rajonale-ndihmë në investime	Skemë		%	%
	Ad hoc		%	%
Ndihmë rajonale-ndihmë operacionale	Kosto për transportimin e mallrave në rajone të pranueshme		%	%
	Kosto shtesë për rajonet e largëta		%	%
Ndihmë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme			%	%
Ndihmë për NVM-në - ndihmë për akses në financim	Ndihmë për financim risku		%	%
	Ndihmë për ndërmarrjet e sapokrijuara		%	%
Ndihmë për kërkim, zhvillim dhe inovacion	Ndihmë për projekte kërkimi dhe zhvillimi	Kërkim themelor	%	%
		Kërkim industrial	%	%
		Zhvillim eksperimental	%	%
		Studime	%	%
	Ndihmë për infrastrukturën e kërkimit		%	%
	Ndihmë për klasterat e inovacionit		%	%
	Ndihmë për inovacionin e NVM-së		%	%

Ndihmë për trajnim		%	%
Ndihmë për punonjësit në kushte të pafavorshme dhe punonjësit me aftësi të kufizuara	Ndihmë për rekrutimin e punonjësve në kushte të pafavorshme në formën e subvencionimit të pagës	%	%
	Ndihmë për punësimin e punonjësve me aftësi të kufizuar në formën e subvencionit të pagës	%	%
	Ndihmë për kompensimin për kostot shtesë të punësimit të punonjësve me aftësi të kufizuara	%	%
	Ndihmë për kompensimin e kostove të asistencës për punonjësit në kushte të pafavorshme	%	%
Ndihmë për mbrojtjen e mjedisit	Ndihma për investime për eficiencën e energjisë	%	%
	Ndihma për investime për projektet e eficiencës në energji të ndërtesave	%	%



	Ndihmë për investim për promovimin e energjisë nga burime të rigjenerueshme	%	%
	Ndihmë operationale për promovimin e energjisë nga burime të rigjenerueshme	%	%
	Ndihmë operationale për promovimin e energjisë nga burime të rigjenerueshme nga impiante me shkallë të vogël	%	%
	Ndihmë për investime për rehabilitimin e vendeve të ndotura	%	%
	Ndihma e investimeve për riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve	%	%
	Ndihma e investimeve për infrastrukturën energjetike	%	%
	Ndihma për studime mjedisore	%	%
Skema të ndihmës shtetërore për të kompensuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore	Maksimumi i intensitetit	%	%
	Lloji i fatkeqësisë natyre	Tërmet Ortekë Rrëshqitjet e dherave Përmbytjet Tornadot Uraganet Shpërthimet vullkanike Zjarret pyjore nga fatkeqësitë natyrore	
	Data e ndodhjes së fatkeqësisë	dd/mm/vvvv	
Ndihmë për transportin e rezidentëve në zona të largëta		%	%
Në rastin e ndihmës <i>ad hoc</i> rajonale, të dhënë sipas këtyre skemave, ju lutem tregoni si intensitetin e grantit, ashtu edhe intensitetin e ndihmës <i>ad hoc</i> .			

SHTOJCA II

1. Emri i përfituesit
2. Lloji i ndërmarrjes
3. Rajoni ku është vendosur ndërmarrja
4. Sektori ku vepron
5. Instrumenti i ndihmës
6. Data e dhënies së ndihmës
7. Objektivi i ndihmës
8. Autoriteti dhënës i ndihmës



VENDIM

Nr. 514, datë 4.9.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 149, DATË 29.2.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE PËR PUNONJËSIT E
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
QEVERITARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, e përmendur në pikën 1 dhe bashkëlidhur vendimit nr. 149, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numërtim dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në datën 1 shtator 2018 dhe përballohen nga fondet e planifikuara për vitin 2018, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LIDHJA NR. 1
STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT QEVERTITAR

Funksioni	Kategoria Klasa	Paga e grupit (lekë)	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë) bëhet
1	2	3	4	6
Titullar institucionit	I-b	1	2%	
Drejtor drejtorie	III-a	1	2%	
Shef sektori	III-a/1	1	2%	
Specialist auditë, specialist në Kryeministri; specialist/redaktor ligjor në Kryeministri	III-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Sekretar (i titullarit dhe i Bordit Drejtues)	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	7000
Specialist finance, specialist kontabilist, specialist buxheti, specialist kosto; specialist i burimeve njerëzore; specialist jurist; specialist prokurimesh; specialist koncept–desing, specialist media, specialist protokollit, specialist ceremoniali, specialist logjistike, specialist shërbimi, specialist trajtimi, specialist merceolog; përgjegjës transporti, përgjegjës shërbimi.	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	
Specialist; specialist protokoll/arkivi; specialist IT; specialist gjelbërimi, specialist inxhinier, sekretar për ish-presidentët	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Kryekryekuzhinier	X		1%	43500
Administues vilash/qendrash	X		1%	12700
Kryepastitçier, kryekamarier	X		1%	17800
Ndihmëspastitçier;	IX		1%	12700
Magazhinier i magazinës qendrore; kryepunëtor Rezidenca Qeveritare; banakier	IX		1%	
Teknik elektrikist/hidraulik/mirëmbajtje/kameraman, fotograf/operator shumëfishimi në Kryeministri; shofer/korrier	VIII		1%	7300
Magazhinier (magazinë dytësore); teknikë të ndryshëm; punëtorë në Rezidenca Qeveritare; kamerier	VIII		1%	
Kuzhinier Rezidenca e K. Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VIII		1%	17800
Kuzhinier Vila 31	VIII		1%	12700
Ndihmesmagazhinier, ndihmëskuzhinier, shofer; teknik dispeçer	VII		1%	
Shofer titullari në Kryeministri	VII		1%	17800
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor pastrimi, punëtor lavanderie; punëtor gjelbërimi; rojë; lavazhier	V		1%	
Punëtorë pastrimi në Kryeministri, receptionist	V		1%	7300

**VENDIM****Nr. 516, datë 4.9.2018****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I RRUGËS ‘DEVOLL’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës ‘Devoll’”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Gramsh.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës të paraqitur në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 3 717 507 (tre milionë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 717 507 (tre milionë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Gramsh.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Gramsh.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Gramsh, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gramsh dhe Bashkia Gramsh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA PROJEKTI “REHABILITIMI I RRUGËS ‘DEVOLL’”

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Rrethi	Sip. e truallit (m²)	Sip. e ndërtimit (m²)	Çmimi i truallit (l/m²)	Çmimi i ndërtimit (l/m²)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera e ndërtimit sipas situacionit me TVSH (lekë)	Vlera e amortizimit (lekë)	Vlera e mbetur (lekë)	Totali	KONFIRMUAR NGA ZVRPP-ja
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	Fadile Meçollari	1842	7/249	Gramsh	36.20	20.15	2,472.00	—	89,486.00	726,948.00	139,574.00	587,374.00	676,860.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Gramsh. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt shërbimi.
2	Dritan Konica	1842	7/330	Gramsh	100.20	61.80	2,472.00	—	247,694.00	1,710,503.00	136,840.00	1,573,663.00	1,821,357.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Gramsh. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt shërbimi.
3	Ramadan Bici	1842	7/247	Gramsh	79.60	33.20	2,472.00	—	196,771.00	1,265,494.00	242,975.00	1,022,519.00	1,219,290.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Gramsh. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt shërbimi.

3,717,507.00

**VENDIM****Nr. 517, datë 4.9.2018****PËR MIRATIMIN E SKEMËS ZBRITËSE
TË TARIFËS SË AUTOSTRADËS
MILOT–MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e skemës zbritëse të tarifës së autostradës Milet–Morinë, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Skema zbritëse, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të fillojë zbatimin duke nisur nga data 17.9.2018.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

Në skemën e zbritjes për përdoruesit e shpeshtë do të përfshihen tri kategori:

1. Automjetet e banorëve të qarkut Kukës;
2. Autobusët nga dhe për në qarkun e Kukësit;
3. Automjetet e përdoruesve të shpeshtë.

1. Në kategorinë e parë të automjeteve të banorëve të qarkut Kukës përfshihen klasat A e B të automjeteve për përdorim personal të regjistruara në qarkun Kukës. Këto automjete do të pajisen me OBU-në (*On Board Unit*) e sistemit *Digital Pass* dhe në OBU nuk do të regjistrohen më shumë se dy automjete për familje. Tarifa e rrugës për 1 (një) kalim për të gjitha automjetet e regjistruara në qarkun Kukës për klasën A do të jetë 50 (pesëdhjetë) lekë me TVSH dhe për automjetet e klasës B do të jetë 100 (njëqind) lekë me TVSH. Kjo tarifë do të jetë e kufizuar për jo më shumë se 44 (dyzet e katër) kalime në muaj dhe e vlefshme për t'u përdorur brenda periudhës 1-mujore nga data e kryerjes së pagesës për këto kalime (nëse ky numër tejkalohet, atëherë

përdoruesi i OBU-së do të duhet të tarifohet sipas vlerës përkatëse të parashikuar në pikën 11.4.5 të kontratës së koncesionit).

Shpenzimet e kryera nga shoqëria koncesionare për koston e pajisjes (OBU) së sistemit *Digital Pass*, e cila do t'u jepet falas banorëve të qarkut Kukës, do të përballohet nga pagesa e parashikuar në pikën 11.8(b) të kontratës së koncesionit. Përdoruesit e qarkut Kukës do të parablejnë në mënyrë të përshkallëzuar deri në 44 kalime me këtë tarifë të reduktuar.

2. Në kategorinë e dytë përfshihen autobusët nga dhe për në qarkun e Kukësit. Tarifa e rrugës për këta autobusë do të jetë 100 (njëqind) lekë me TVSH për 1 (një) kalim.

3. Në kategorinë e tretë përfshihen përdoruesit e shpeshtë të autostradës Milet–Morinë, automjetet e të cilëve do të pajisen me OBU-në (kostoja e OBU-së do të përballohet nga këta përdorues të shpeshtë të autostradës) dhe nuk do të regjistrohen më shumë se dy automjete. Lidhur me kategorinë “Përdorues të shpeshtë”, pa dallim mjeti, ulja e tarifës do të bëhet për numër kalimesh, pasi sistemi do të funksionojë në mënyrë të tillë që do të regjistrojë numrin e kalimeve për çdo mjet, si më poshtë vijon:

i. Nga 20 (njëzet) deri në 30 (tridhjetë) kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 10 (dhjetë) %;

ii. Mbi 30 (tridhjetë) deri në 50 (pesëdhjetë) kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 20 (njëzet) %;

iii. Mbi 50 (pesëdhjetë) deri në 60 (gjashtëdhjetë) kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 30 (tridhjetë) %;

iv. Mbi 60 (gjashtëdhjetë) kalime në muaj, përdoruesi i shpeshtë do të përfitojë një zbritje në masën 40 (dyzet) %.

Kjo skemë zbritjesh për të tria kategoritë e përdoruesve të shpeshtë do të fillojë të zbatohet duke nisur nga data 17.9.2018.

**VENDIM****Nr. 518, datë 4.9.2018****PËR SHËRBIMET E KUJDESIT
SHOQËROR KOMUNITAR E
REZIDENCIAL, KRITERET,
PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E
TYRE DHE MASËN E SHUMËS PËR
SHPENZIME PERSONALE PËR
PËRFITUESIT E SHËRBIMIT
TË ORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të pikës 5, të nenit 15, dhe të pikës 3, të nenit 23, të ligjit nr. 121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. FUSHA E VEPRIMIT**

1. Ky vendim përcakton:

a) Kriteret dhe procedurat për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial sipas llojit të shërbimit dhe kategorisë përkatëse të përfituesit;

b) Masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.

**II. SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR
KOMUNITAR E REZIDENCIAL**

2. Shërbimet e kujdesit shoqëror organizohen në:

a) Shërbime parashoqërore: informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi *on-line*;

b) Shërbime në komunitet: shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.

c) Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.

3. Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe ofrohen nga strukturat e posaçme të shërbimeve shoqërore në kuptim të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

4. Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen

nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal:

Shërbimi në shtëpi përfshin:

i. shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim psikologjik e ligjor sipas rasti;

ii. shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;

iii. dhënien e medikamenteve sipas recetës së mjekut apo shërbime të tjera të kujdesit të shëndetit;

iv. mbajtjen e higjienës personale;

v. përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti.

5. Shërbimi i përkujdesjes alternative siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi. Shërbimi ofrohet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin e Këshillit të Ministrave për shërbimin e kujdestarisë për:

i. fëmijë pa kujdes prindëror;

ii. fëmijë të privuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga mjedisi familjar.

6. Shërbimi multifunksional përfshin një shumëllojshmëri shërbimesh multidisiplinare të specializuara dhe u ofrohet të gjitha kategorive në nevojë.

Shërbimi multifunksional siguron:

i. shërbime për rehabilitimin fizik dhe psikosocial;

ii. këshillime ligjore falas, këshillim për prindërimin, punësimin, edukimin shëndetësor, arsimim, argëtim;

iii. fuqizimin e individit/familjes;

iv. çdo shërbim tjetër të nevojshëm të identifikuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

7. Qendrat ditore ofrojnë shërbim gjysmëditor ose të plotë ditor, të cilat mund të përdoren një ose disa ditë në javë dhe sigurojnë shërbime specifike sipas kategorisë së përfituesve:

i. fëmijë që jetojnë në situatë ruge dhe fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë shërbime për higjienë personale, ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin;

ii. personat me aftësi të kufizuara - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, ortofoni, terapi okupacionale,



mbështetje psikologjike, përkujdesje fizike, ushqim për qëndrimin ditor;

iii. të moshuarit - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet dhe ushqim.

8. Shërbimi i emergjencës 72 orë u ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. Ky shërbim ngrihet për:

i. viktima të dhunës në familje dhe fëmijët;

ii. fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara;

iii. të moshuarit apo individë të braktisur në situatë rruge.

9. Shërbimi për të pastrehët ofrohet për individë mbi 18 vjeç që nuk kanë strehë banimi dhe janë në vështirësi ekonomike dhe siguron:

i. strehim gjatë natës;

ii. mensë;

iii. mbështetje me këshillim dhe referim për fuqizim dhe riintegrim sa më të shpejtë.

10. Shërbimi i strehimit të mbrojtur u ofrohet viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë. Ai organizohet në formën e një strukture banimi të veçantë, sipas specifikave të grupit të përfituesve ose në formën e banesave individuale, si dhe siguron:

i. strehim, siguri fizike, ushqim, kujdes shëndetësor, trajtim psikologjik dhe emocional, këshillim dhe referim të shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese në tregun e punës për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, në përputhje me vlerësimin e kryer për nevojat e tyre;

ii. mbështetje për jetesë brenda dhe jashtë ambientit të banimit, terapi rehabilituese, këshillim dhe mbështetje për integrim në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara.

11. Shërbime rezidenciale janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe, në çdo rast, përfshijnë të paktën shërbime të kujdesit 24-orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë.

Në këtë shërbim përfshihen:

a) Shërbime në qendrat e zhvillimit, që sigurojnë përmirësimin e statusit dhe të cilësisë së jetës së

individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç, dhe përfshijnë:

i. terapi intensive psikosociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;

ii. shërbim psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale;

iii. aftësim i parametrave fizikë;

iv. shërbime specifike ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo të aftësisë për të komunikuar;

v. shërbime riaftësimi për punë;

vi. terapi zhvillimi.

b) Strehimi afatgjatë, i cili i sigurohet individit që ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, me qëllim përmbushjen e nevojave themelore. Ky shërbim u ofrohet:

i. personave me aftësi të kufizuara, sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje apo në familje kujdestare, duke u dhënë formën e duhur të kujdesit;

ii. të moshuarve dhe të sëmurëve rëndë, të cilët vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore, kur nuk është e mundur të sigurohet kujdesi në familje apo familje kujdestare.

c) Shërbimi në strehëza, që u siguron përfituesve shërbim specifik, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim rezidencial ofrohet në mënyrë të përkohshme:

i. për fëmijën që gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik apo në situatë rruge;

ii. për fëmijën në nevojë të mbrojtjes së veçantë;

iii. për të rriturin ose të moshuarin që nuk ka vendbanim të përhershëm apo të përkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;

iv. për gratë dhe vajzat shtatzëna ose për prindin e vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç;

v. për fëmijën dhe të rriturin, viktimë të dhunës në familje, të abuzimit, viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit ose në rrezik të mundshëm për jetën;



vi. për fëmijën dhe të rriturin në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësisë nga droga ose alkooli apo përjashtimit social;

vii. për fëmijën në konflikt me ligjin.

12. Shërbime të specializuara janë shërbimet që ofrohen në nivel kombëtar, rajonal apo bashkie nga profesionistë të specializuar në fusha të caktuara dhe përfshijnë:

a) Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese publike dhe jopublike që ofrohen në territorin e bashkisë ose në territorin e rajonit për fëmijë:

- i. me çrregullime përvazive të zhvillimit;
- ii. me prapambetje mendore;
- iii. me çrregullime në komunikim;
- iv. në nevojë për aftësim fizik.

b) Rehabilitim për viktimat e abuzimit seksual që ofrohet për viktimën e abuzimit seksual. Kur vlerësohet se jetesa në familje nuk mund të vijojë pa ndërprerje, shërbimet rehabilituese, terapitë për rehabilitim shëndetësor e psikologjik dhe çdo nevojë tjetër e identifikuar për viktimën e abuzimit seksual ofrohen nga shërbimet ekzistuese komunitare. Shërbimi i specializuar siguron:

- i. strehimin;
- ii. sigurinë fizike;
- iii. ushqimin;
- iv. terapinë dhe rehabilitimin psikologjik;
- v. kujdesin shëndetësor;
- vi. asistencën juridike;
- vii. shërbime riintegruese.

c) Strehëza për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, që ofrojnë shërbim në mënyrë të përkohshme, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit, viktimat e dhunës në familje që kanë marrë urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje dhe sigurojnë:

- i. strehimin;
- ii. sigurinë fizike;
- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. asistencën juridike;
- vi. rehabilitimin psikosocial;
- vii. fuqizim për punësim;
- viii. shërbime riintegruese;

ç) Qendrën për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, që ofron shërbim në mënyrë të përkohshme, duke mundësuar:

- i. strehimin;
- ii. sigurinë fizike;
- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. asistencën juridike;
- vi. rehabilitimin psikosocial në varësi të nevojave të identifikuar të viktimës së trafikimit.

d) Shërbim rehabilitimi për personat me varësi nga droga/alkooli në nivel komunitar, që ofrohet si shërbim ditor dhe përfshin shërbime rehabilituese sipas nevojave të identifikuar nga njësitë e specializuara mjekësore dhe nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit. Në kushtet rezidenciale shërbimi ofrohet në mënyrë të përkohshme dhe përfshin shërbimet:

- i. rehabilituese;
- ii. strehimin;
- iii. ushqimin;
- iv. kujdesin shëndetësor;
- v. rehabilitimin psikosocial;
- vi. terapinë okupacionale në varësi të nevojave të identifikuar të përfituesve të shërbimit.

III. PROCEDURAT PËR PËRFTITIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNITARE E REZIDENCIALE

13. Procesi i përfitimit të shërbimeve komunitare dhe rezidenciale fillon me kërkesën e paraqitur nga:

a) Individit apo familja në nevojë për shërbimin specifik;

b) Punonjësi i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit;

c) Organizata joqeveritare dhe ofrues të shërbimeve publike e jopublike;

ç) Punonjësi i policisë së shtetit;

d) Punonjësi apo institucionet që janë në kontakt me individin apo familjen në nevojë për shërbim;

dh) Çdo person tjetër i interesuar.

14. Kërkesa për marrjen e shërbimit në qendra komunitare apo shërbim rezidencial, me përjashtim të shërbimeve të emergjencës, kryhet pranë punonjësit social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, i cili drejton procesin e përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për përdorimin e shërbimit specifik dhe i siguron dokumentet e nevojshme nëpërmjet kërkesës në institucionet përkatëse ose Regjistrin Elektronik Kombëtar.



15. Vlerësimi i nevojave dhe i riskut, i cili përfshin analizimin e të gjitha informacioneve dhe dokumenteve, në konsultim me përfituesin, realizohet në mjedisin e tij (në shtëpi, në shkollë), duke përfshirë vlerësimin shumëdisiplinor për rastet komplekse.

16. Punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit informon dhe jep këshilla bazë për të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim, këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, informim bazë për pagesat sociale në të holla.

17. Punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit, brenda 10 ditësh nga fillimi i procesit të përfitimit të shërbimit, sipas përcaktimit të pikës 13 të këtij kreu, pasi merr informacionin e plotë nga sistemet e jashtme, e kalon informacionin te komisioni multidisiplinor, i ngritur në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të bërë vlerësimin e plotë të rastit.

18. Komisioni multidisiplinor shqyrton kërkesën e dokumentacionin dhe, pas marrjes së vendimit, përcjell vendimin e dokumentacionin pranë ofruesit të shërbimit ose, në rast refuzimi, pranë njësisë që ka marrë nismën për vendosjen e individit në institucion përkujdesi rezidencial.

19. Punonjësi social në nivel qarku shikon në sistem rastet për trajtim dhe më pas përcakton planin e trajtimit të rastit dhe shikon performancën e punonjësve dhe ecurinë e trajtimit të rastit. Pasi merr vendimin për rivlerësimin e rastit, përcakton hapat e mëtejshëm të trajtimit të tij.

20. Titullari i institucionit të përkujdesit shoqëror (në vijim "IPSH") shikon në sistem rastet për trajtim. Përcakton planin e trajtimit të rastit dhe shikon performancën e punonjësve dhe ecurinë e trajtimit të rastit. Merr vendim për rivlerësimin e rastit dhe përcakton hapat e mëtejshëm. Mbyll rastin.

21. Punonjësi në IPSH ndjek detyrat dhe hedh veprimet e ndërmarra dhe dokumentacionin e mbledhur për rastin. Plotëson raportin e vlerësimit periodik dhe raportin e mbylljes së rastit.

22. Bashkërendimi i mbështetjes dhe referimi te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror. Për shërbimet në nivel rajonal dhe qendror vendimi për referimin merret bashkërisht me SHSSH-në.

23. Me përjashtim të viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe të mundshme të trafikimit, për individët dhe familjet në nevojë, vendimi për t'i ofruar shërbimin e kërkuar merret brenda një muaji nga data e kërkesës nga:

a) Këshilli i Bashkisë, në rastin kur shërbimi i kërkuar funksionon në territorin e bashkisë respektive ku banon individ apo familja në nevojë mbi bazën e propozimit të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkisë;

b) Këshilli i Qarkut, në rastin kur shërbimi i kërkuar përfshihet në territorin e qarkut ku banon kërkuesi i shërbimit, mbi bazën e propozimit të ardhur nga Këshilli i Bashkisë që përfshihet në territorin e qarkut;

c) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në rastet kur në territorin e bashkisë dhe qarkut ku banon kërkuesi i shërbimit nuk ka shërbim rezidencial për nevojat e individit.

24. Pas marrjes së vendimit sipas përcaktimit të pikës 19 të këtij kreu, dokumentacioni bashkë me vendimin përcillen pranë shërbimit specifik ose i rikthehen individit apo familjes së interesuar në rast se kërkesa nuk është miratuar.

25. Për çdo përfitues të shërbimit rezidencial, çdo 6 muaj rivlerësohen të gjitha kushtet që kanë shkaktuar largimin nga familja apo shërbimi komunitar. Në rast të konstatimit që arsyet e marrjes së shërbimit rezidencial janë shuar, ndiqen procedurat sipas standardit të shërbimit për largimin nga shërbimi rezidencial.

26. Në rastet e emergjencës kur në territorin e bashkisë dhe qarkut respektiv mungojnë shërbime emergjence 72-orëshe, por ofrohet shërbim rezidencial që u përgjigjet nevojave të individit apo familjes në situatë emergjence, kryhet akomodimi i menjëhershëm pa prituri vendimin e autoriteteve vendimmarrëse për akomodimin në shërbimin rezidencial. Pranimi i menjëhershëm në shërbimin rezidencial shoqërohet me procesverbalin e punonjësit të policisë; në rastin e fëmijës procesverbali dorëzohet nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, ku përshkruhen rrethanat në të cilën është konstatuar rasti i emergjencës. Brenda 24 orëve nga pranimi në shërbim të rastit emergjent, ofruesi i shërbimit njofton njësinë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkinë ku ka gjendjen civile individit i akomoduar. Kjo e fundit, brenda 72 orësh, administron rastin,



me qëllim vijimin e shërbimit, duke konsideruar me prioritet shërbimet në komunitet.

27. Përpunimi i të dhënave personale, subjekt i rregullimeve të këtij vendimi, kryhet sipas përcaktimit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

IV. KRITERET E PËRFTIMIT TË SHËRBIMIT DHE PËRMBAJTJA E DOSJES

28. Organet publike në nivel vendor sigurojnë planifikimin në planet sociale dhe realizimin e shportës bazë të shërbimeve komunitare të kujdesit shoqëror, të përcaktuara në pikat 4–10 të këtij vendimi, në mënyrë uniforme, duke zbatuar kriteret për përfitimin e shërbimit dhe dokumentacionin e nevojshëm për kualifikimin e individit si përfitues i tij.

29. Format i planeve sociale miratohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

30. Procedurat e ngritjes, organizimit të shërbimeve, të përcaktuara në pikën 28 të këtij kreu, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

31. Shërbimi në shtëpi, sipas përcaktimit të pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kriterë:

a) Të jenë të moshuar ose persona me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari;

b) Kanë nevojë për një shërbim që nuk ofrohet nga shërbimet komunitare në territorin ku banojnë.

32. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

a) Epikrizën shëndetësore dhe fotokopje të kartelës mjekësore;

b) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;

c) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

ç) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

33. Shërbimi në qendër komunitare multifunksionale, sipas përcaktimit të pikës 6, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet

që kanë nevojë për një apo disa shërbime që ofrohen në qendrën komunitare sipas nevojës së identifikuar gjatë procesit të menaxhimit të rastit, të përcaktuar në kreun III të këtij vendimi;

34. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

a) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;

b) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

35. Shërbimi në qendër ditore për fëmijë, sipas përcaktimit të pikës 7/i, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kriterë:

a) Fëmijë të identifikuar në situatë rruge;

b) Fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike;

c) Fëmijë në konflikt me ligjin.

36. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Fotografinë e fëmijës (2 copë);

c) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

ç) Fotokopjen e kartës së identitetit të prindërve;

d) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;

dh) Raport me të dhëna nga struktura policore të interesuara sipas rastit, dhe/ose komisiariati i policisë që mbulon territorin ku banon, në rastin kur fëmija është konstatuar i neglizhuar apo pa kujdes prindëror.

37. Shërbimi në qendër ditore për persona me aftësi të kufizuara, sipas përcaktimit të pikës 7/ii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga persona me aftësi të kufizuara të përcaktuar nga komisioni



përgjegjës i vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe që kanë të nevojshme shërbime rehabilituese dhe riintegruese.

38. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Dokumentin që vërteton vendimin e komisionit përgjegjës për përcaktimin e aftësisë së kufizuar;

ç) Fotografinë e individit (2 copë);

d) Deklaratën me shkrim, të noterizuar, për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit për pranimin e personit në shërbimin ditor.

39. Shërbimi në qendër ditore për të moshuarit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 7/iii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:

a) Të jenë të moshuar që kanë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;

b) Të përfitojnë pension social ose pension minimal në përputhje me legjislacionin përkatës;

c) Të jenë të vetmuar e të braktisur sipas verifikimeve të kryera nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

40. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

a) Certifikatën e gjendjes civile nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Fotografinë e individit (2 copë);

ç) Raportin nga komisioni mjekoligjor, që përcakton gjendjen shëndetësore të personit;

d) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore për masën e pensionit që përfiton nga sistemi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

dh) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes.

41. Shërbimi i emergjencës 72 orë, sipas përcaktimit të pikës 8, të kreut II, të këtij vendimi, ofrohet në mënyrë të menjëhershme dhe i vetmi dokumentacion i nevojshëm në momentin e pranimit në këtë shërbim, sipas rastit, është:

a) Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes - për viktimat të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre;

b) Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes ose procesverbali i policisë - për fëmijë pa kujdes prindëror ose të dhunuar, të shfrytëzuar, të abuzuar, fëmijë me aftësi të kufizuara;

c) Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes ose procesverbali i policisë - për të moshuar të braktisur në situatë rruge.

42. Brenda 24 orëve nga vendosja në shërbimin e emergjencës, punonjësi social i shërbimit njofton punonjësin social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit për të vijuar me menaxhimin e rastit të përcaktuar në kreun III të këtij vendimi.

43. Shërbimi për të pastrehët, sipas përcaktimit të pikës 9, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere:

a) Të jenë mbi 18 vjeç e të pastrehë;

b) Të jenë përfitues të ndihmës ekonomike ose në proces aplikimi për ndihmën ekonomike.

44. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;

b) Fotografinë e individit (2 copë);

c) Raportin nga komisioni mjekoligjor, që përcakton gjendjen shëndetësore të personit;

ç) Përbërjen familjare aktuale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

d) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

dh) Verifikimi i aplikimit për ndihmë ekonomike ose për përfitimin e ndihmës ekonomike;

e) Informacion mbi pasuritë e paluajtshme nga regjistri i ZRPP-së.

45. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje, sipas përcaktimit të pikës 10/i, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që janë viktimat të dhunës në familje, që e kanë të



pamundur të jetojnë në mjedisin e mëparshëm familjar apo të pastrehë.

46. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Urdhrin e mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes;

b) Procesverbalet e referimit nga punonjësi i Policisë së Shtetit;

c) Raportin e vlerësimit të punonjësit social të sektorit të dhunës në njësitë e qeverisjes vendore;

ç) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

d) Raportin e komisionit mjekoligjor;

dh) Vërtetimin nga ZRPP-ja dhe ALUIZNI që nuk zotëron pronë;

e) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

47. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për viktimat e trafikimit ose viktimat të mundshme trafikimi, sipas përcaktimit të pikës 10/i, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët, viktimat të trafikimit ose viktimat të mundshme trafikimi mbi 18 vjeç, që e kanë të pamundur, për arsye të sigurisë apo nevojës për shërbime rehabilituese, të jetojnë në mjedisin e mëparshëm familjar.

48. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Procesverbalet e referimit nga punonjësi i Policisë së Shtetit dhe punonjësi social i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Raportin e vlerësimit të punonjësit social të Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit mbi rrethanat;

ç) Verifikimin mbi gjendjen social-ekonomike të familjes;

d) Raportin e komisionit mjekoligjor;

dh) Të ardhurat e familjes nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

49. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për personat me aftësi të kufizuara, sipas përcaktimit të pikës 10/ii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:

a) Persona me aftësi të kufizuara të vlerësuar nga komisioni përgjegjës i vlerësimit të aftësisë së kufizuar:

i. mendore;

ii. fizike;

iii. sensore;

b) Janë të pastrehë dhe/ose familjarë të tyre nuk mund të kujdesen për ta;

c) Kanë zhvilluar aftësitë për jetesë të pavarur ose gjysmë të pavarur.

50. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Fotografinë e individit (2 copë);

ç) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

d) Vërtetimin e gjendjes social-ekonomike të familjes, si dhe të të ardhurave personale të personit me aftësi të kufizuara, të lëshuar nga administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore;

dh) Kërkesën për përfitimin e shërbimit;

e) Vërtetimin nga ZRPP-ja që vërtetojnë mungesën e strehimit;

ë) Vërtetimin nga tatimet dhe sigurimet shoqërore, që provojnë nivelin e të ardhurave të deklaruara nga individ, nga sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

51. Shërbimet rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara, sipas përcaktimit të pikës 11/a, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga individët që plotësojnë këto kritere:

a) Vendimi i komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar:

i. mendore;

ii. fizike;

iii. sensore;



b) Mosha e përfituesve të këtij shërbimi është nga 0–21 vjeç;

c) Nevoja për terapi zhvillimi për personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund t'i përfitojnë përmes shërbimeve komunitare.

52. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

c) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

ç) Fotografinë e individit (2 copë);

d) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes, si dhe të të ardhurave personale të personit me aftësi të kufizuar, të lëshuar nga administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore, sipas formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

dh) Kërkesën për sistemimin e personit në institucion;

e) Dokumentin e shkollës që ka ndjekur personi;

ë) Deklaratën me shkrim, të noterizuar, për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit për pranimin e personit në institucion.

53. Strehimi afatgjatë për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, sipas përcaktimit të pikës 11/b, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:

a) Të jenë persona me aftësi të kufizuara për të cilët është i pamundur të sigurohet kujdesi në familje dhe sipas moshës, llojit dhe shkallës së dëmtimit i jepen format e duhura institucionale të kujdesit;

b) Të jenë të moshuar e të sëmurë rëndë, që vuajnë nga ndryshime të përhershme të gjendjes shëndetësore.

54. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Fotografinë e individit (2 copë);

ç) Raportin mjekoligjor që përcakton gjendjen shëndetësore të personit;

d) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore për përfitimin dhe masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë apo ndonjë lloj tjetër pensioni;

dh) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar që përcakton aftësinë e kufizuar në rastin e personit me aftësi të kufizuar;

e) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes, si dhe të të ardhurave personale të personit me aftësi të kufizuar të lëshuar nga administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore, sipas formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

ë) Verifikimin nga sistemi bankar të burimeve financiare të individit, i marrë me autorizimin përkatës të individit.

55. Shërbimi në strehëza për fëmijë, sipas përcaktimit të pikës 11/c/i/ii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:

a) Fëmijë të moshës 0–18 vjeç, që i kanë vdekur prindërit dhe nuk është bërë i mundur në mënyrë të menjëhershme shërbimi i kujdesit në familje kujdestare apo birësimi;

b) Fëmijë i lindur jashtë martese dhe që, për rrethana të gjendjes ekonomiko-shoqërore, nuk mund ta rrisë njëri nga prindërit;

c) Prindërve të fëmijës u është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;

ç) Prindërit e fëmijës janë ndaluar/arrestuar ose dënuar me vendim të formës së prerë me heqje lirie dhe deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijës në shërbimet e përkujdesjes shoqërore;

d) Fëmija është deklaruar i braktisur nga gjykata në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;

dh) Gjykata, me vendim të formës së prerë, ka vendosur sistemimin e fëmijës në institucionet e përkujdesjes shoqërore, pavarësisht nga gjendja familjare;



e) Familjet e të cilëve deklarojnë se janë në krizë të rëndë sociale për shkak se prindërit janë të divorcuar ose janë rimartuar;

ë) Prindërit e të cilëve shtrohen në spital ose dërgohen për kurim jashtë shtetit dhe deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijëve në institucionet e përkujdesjes shoqërore deri sa njëri ose të dy prindërit janë fizikisht të aftë për t'u kujdesur për fëmijët;

f) Fëmijë që nuk mbikëqyren më ose janë larguar nga prindi apo kujdestari, deri në momentin e identifikimit dhe gjetjes së prindit apo kujdestarit të tyre.

56. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Fotografitë e fëmijës (2 copë);

c) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

ç) Certifikatën e vdekjes së prindërve, sipas rastit, nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile;

d) Vendimin e gjykatës për heqjen e së drejtës prindërore ose kopje të noterizuar të tij, sipas rastit;

dh) Deklaratën e noterizuar të nënës ose, në pamundësi, deklaratën zyrtare të drejtorit të institucionit shëndetësor ku është braktisur fëmija, në rastet e braktisjes së fëmijës në maternitet, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 8, të ligjit nr. 18/2017, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;

e) Epikrizën shëndetësore, kartelën mjekësore ose fotokopjen e saj, me të dhënat laboratorike dhe për vaksinimin;

ë) Procesverbalin e lindjes së fëmijës në rastin kur fëmija është braktisur në maternitet;

f) Procesverbalin dhe urdhrin e mëparshëm të pranimit/transferimit të fëmijës me vendim komisioni, në rastin e lëvizjes së tij nga një institucion në tjetrin, për shkak të moshës;

g) Fotokopje të kartës së identitetit të prindërve;

gj) Dokumentin e shkollës që ka ndjekur fëmija;

h) Deklaratën noteriale për dhënien e pëlqimit të të dy prindërve ose të kujdestarit/kujdestarëve për vendosjen e tij në institucion;

i) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes të kryer nga administratori shoqëror sipas formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

j) Dokumentet e noterizuara të pronësisë së banesës, si dhe dokumente të tjera për të drejtat pasurore, kur fëmija është trashëgimtar i drejtpërdrejtë, për rastet kur prindërit kanë vdekur ose kur, me vendim gjykatë, u është hequr e drejta prindërore;

k) Të dhëna nga struktura policore të interesuara sipas rastit, komisarati i policisë që mbulon territorin ku banon.

57. Periudha e sistemimit të fëmijëve nga materniteti në shtëpinë e foshnjës është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e lindjes së fëmijës, por mund të zgjatet në varësi të gjendjes shëndetësore të fëmijës.

58. Shërbimi në strehëza për të moshuarit, sipas përcaktimit të pikës 11/c/iii, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohet nga subjektet që plotësojnë këto kritere:

a) Përfituesit e shërbimit kanë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi;

b) Përfitojnë pension social ose pension minimal në përputhje me legjislacionin përkatës;

c) Nuk zotërojnë banesë apo llogari bankare;

ç) Janë të vetmuar dhe të braktisur sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit.

59. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna:

a) Certifikatën personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Certifikatën familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

c) Fotografinë e individit (2 copë);

ç) Raportin mjekësor që përcakton gjendjen shëndetësore;

d) Vërtetimin nga sigurimet shoqërore me masën dhe llojin e pensionit që përfiton, nga sistemi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

dh) Verifikimin e gjendjes social-ekonomike të familjes të kryer nga administratori shoqëror sipas



formularit të posaçëm të miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale;

e) Vërtetimin nga ZRPP-ja dhe ALUIZNI për pronat që ka në zotërim;

ë) Verifikimin nga sistemi bankar të burimeve financiare të individit, i marrë me autorizimin përkatës të individit.

60. Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese, sipas përcaktimit të pikës 12/a, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga persona me aftësi të kufizuara, të vlerësuar nga komisioni përgjegjës i vlerësimit të aftësisë së kufizuar, kur mjeku specialist i referon për shërbime rehabilituese, duke specifikuar qartësisht shërbimin e nevojshëm.

61. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Vendimin e komisionit përgjegjës të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

c) Referencën nga mjeku specialist;

ç) Referimin në shërbimin rehabilitues nga Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit.

62. Shërbimet rezidenciale për viktimat e dhunës në familje, sipas përcaktimit të pikës 12/c, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga individët që plotësojnë këto kritere:

a) Fëmijët 0–18 vjeç të dhunuar në familje, të shoqëruar nga nëna ose të pashoqëruar nga prindërit, të identifikuar nga strukturat përgjegjëse si viktima të dhunës në familje. Për djemtë mbi 13 vjeç, pas kryerjes së vlerësimit psikosocial;

b) Vajza dhe gra, viktima të dhunës në familje, të pajisur me urdhër mbrojtjeje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje.

63. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Urdhrin e mbrojtjes/urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes;

b) Procesverbalet e referimit nga punonjësi i Policisë së Shtetit;

c) Procesverbalet nga punonjësit socialë të sektorit të dhunës në njësitë e qeverisjes vendore;

ç) Raportin mjekoligjor;

d) Vendimin e gjykatës për vendosje në shërbim rezidencial.

64. Shërbimet rezidenciale për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit, sipas përcaktimit të pikës 12/ç, të kreut II, të këtij vendimi, përfitohen nga fëmija, personi mbi 18 vjeç, shtetas shqiptar apo i huaj që, në bazë të intervistës formale të zhvilluar sipas procedurave standarde, vlerësohet si viktimë e mundshme ose viktimë trafikimi.

65. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Deklaratën e pranimit të marrjes së shërbimit rezidencial, e firmosur nga përfituesi;

b) Deklaratën e konfidencialitetit për përkthyesit (kur viktima/viktima e mundshme e trafikimit është shtetas/e i/e huaj);

c) Lejen e informuar për intervistën formale;

ç) Formatin e konkludimit të intervistës formale;

d) Formatin e konkludimit pa intervistë formale (për viktimat e mundshme të trafikimit);

dh) Deklaratën e vendimit të informuar për ndihmë;

e) Kërkesën për vlerësimin social-ekonomik dhe të sigurisë së parakthimit vullnetar (për viktimat /viktimat e mundshme të riatdhesuara);

ë) Raportin për vlerësimin e situatës familjare para kthimit vullnetar të asistuar;

f) Procesverbalet e referimit nga punonjësi social i zyrave rajonale dhe nga punonjësi i antitrafikut;

g) Autorizimin e prindërve/kujdestarit për kthim të asistuar të të miturit/miturës;

gj) Autorizimin e prindërve/kujdestarit për udhëtimin e të miturit/miturës.

66. Shërbimi i rehabilitimit rezidencial për personat me varësi nga droga, sipas përcaktimit të pikës 12/d, të kreut II të këtij vendimi, përfitohet nga individët që plotësojnë këto kritere:



a) Janë përdorues të drogës që kanë të nevojshëm shërbimin e rehabilitimit nga droga larg nga mjedisi që ka nxitur përdorimin e drogave;

b) Përdorues i drogës që pranon të përfshihet në shërbimin e rehabilitimit.

67. Pas depozitimit të kërkesës me shkrim nga të interesuarit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 13, të kreut III, të këtij vendimi, punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve plotëson dosjen e individit me këto dokumente dhe të dhëna, si më poshtë vijon:

a) Certifikatën e lindjes nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010;

b) Epikrizën shëndetësore të përgatitur nga mjeku toksikolog;

c) Fotografinë e individit (2 copë);

ç) Vlerësimin e kryer nga psikologu klinik;

d) Raportin mbi shërbimet komunitare të ofruara ndaj individit në kushtet komunitare i përgatitur nga punonjësi social i njësisë vendore që ka menaxhuar rastin;

dh) Deklaratën me shkrim, të noterizuar, për dhënien e pëlqimit të prindit ose të kujdestarit për pranimin e personit në institucion kur ky i fundit është minoren.

V. MASA E SHUMËS PËR SHPENZIME PERSONALE DHE NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME PËR PËRFITUESIT E SHËRBIMIT REZIDENCIAL E KOMUNITAR

68. Subjekteve përfituese të shërbimit rezidencial publik, sipas përcaktimit të këtij vendimi, u jepet, për shpenzime personale, një shumë parash, si më poshtë vijon:

a) Personave të moshuar që nuk kanë të ardhura, që janë të vendosur në shërbimin rezidencial për të moshuarit, 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj;

b) Fëmijëve të moshës 2–5 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 300 (treqind) lekë në muaj;

c) Fëmijëve të moshës 6–15 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 000 (një mijë) lekë në muaj;

ç) Fëmijëve të moshës 16–18 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj;

d) Personave, që marrin shërbime në qendrat e zhvillimit, 1 000 (një mijë) lekë në muaj;

dh) Viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj;

e) Viktimave të trafikimit/viktimave të mundshme të trafikimit, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.

69. Procedurat e shpërndarjes së shumës së parave që u jepet kategorive të përcaktuara në pikën 67 të këtij vendimi, për shpenzime personale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen sociale.

70. Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare miratohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale. Nivelet e kuotave të shpenzimeve në institucionet private nuk mund të jenë më të ulëta se ato në institucionet publike.

71. Nivelet e kuotave të shpenzimeve të përkujdesit shoqëror në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare indeksohen çdo vit sipas indeksit të çmimeve të konsumit, nëngrupi “Ushqime dhe pije joalkoolike”.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

72. Ngarkohen strukturat përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkive dhe qarqeve dhe njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje dhe me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi që rregullon fushën e veprimtarisë së tyre.

73. Kreu I, i vendimit nr. 113, datë 31.1.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 425, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar, shfuqizohen.

74. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 30, datë 30.8.2018****PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
E PËRBASHKËT**

**NR. 385/7, DATË 28.6.2017, “PËR
CAKTIMIN E TARIFAVE PËR
SHËRBIMET E OFRUARA NGA
SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR
PRIVAT”, TË MINISTRIT TË
DREJTËSISË DHE MINISTRIT TË
FINANCIVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 47, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 385/7, datë 28.6.2017, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Privat”, bëhen këto ndryshime:

I. Në seksionin III:

1. Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbarrimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar si kthim shume dhe/ose pagim detyrimi, përlogaritet si më poshtë:

a) Tabela e tarifave fikse përmbarrimore në lek, sipas vlerave të detyrimit:

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në lekë mbi vlerën e detyrimit)
1 – 10,000	6,000
10,001 – 20,000	7,000
20,001 – 30,000	8,000
30,001 – 40,000	9,000
40,001 – 50,000	10,000
50,001 – 60,000	11,000
60,001 – 70,000	12,000
70,001 – 80,000	13,000
80,001 – 90,000	14,000
90,001 – 100,000	15,000
100,001 – 150,000	17,000
150,001 – 200,000	18,000
200,001 – 250,000	20,000
250,001 – 300,000	22,000
300,001 – 350,000	24,000
350,001 – 400,000	26,000
400,001 – 450,000	28,000
450,001 – 500,000	30,000

b) Tabela e tarifave fikse përmbarrimore në %, sipas vlerave të detyrimit:

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në përqindje mbi vlerën e detyrimit)
500,001 – 2,000,000	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	3.85%
5,000,001 – 10,000,000	2.75%
10,000,001 – 30,000,000	2.2%
30,000,001 – 90,000,000	1.65%
Mbi 90,000,000	1.1% Minimumi 1, 485,000 lekë Maksimumi 2, 500,000 lekë



2. Pika 3 ndryshon me këtë përmbajtje:

“3. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim jomonetar dhe të pavlerësueshëm, përlllogaritet në varësi të objektit të ekzekutimit si më poshtë:

a) Për reklamimin e një sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, vlera e tarifës fikse përlllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore.

b) Për lirin dhe vënien në posedim të një sendi të paluajtshëm, vlera e tarifës fikse përlllogaritet në masën e 2 pagave bazë minimale mujore, kur sendi nuk ka një vlerë monetare të përcaktuar për çmimin e shitjes sipas të dhënave nga regjistri i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo sipas vlerësimit të një eksperti të pavarur të caktuar nga gjykata dhe/ose përmbartuesi gjyqësor privat. Në rast se sendi i paluajtshëm ka një vlerë referuese për çmimin e shitjes së tij sipas të dhënave të zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo sipas vlerësimit të ekspertit, atëherë tarifa fikse përlllogaritet në përqindje mbi vlerën e sendit, sipas tabelës së treguar në pikën 2 të këtij seksioni.

c) Për vënien në posedim të sendit të luajtshëm, vlera e tarifës fikse përlllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore kur sendi nuk ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes. Në rast se sendi i luajtshëm ka një vlerë të përcaktuar për çmimin e shitjes në dokumentacionin e regjistruar apo ka një vlerë të përcaktuar, për të cilën ky send është regjistruar si barrë sigurorese, atëherë tarifa fikse do të përlllogaritet në përqindje sipas tabelës së parashikuar në pikën 2 të këtij seksioni.

d) Për marrjen e fëmijës dhe lejin e së drejtës së vizitës, vlera e tarifës fikse përlllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore, ndërsa tarifa fikse që lidhet me ekzekutimin e masës së pensionit ushqimor, është një shumë e plotë që përputhet me normën minimale të detyrimit ushqimor, të përcaktuar me ligj.

e) Për organizimin dhe shitjen e sendit në ankand, vlera e tarifës fikse përlllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore;

f) Për zbatimin e një vendimi gjyqësor ose titulli ekzekutiv me objekt të pavlerësueshëm, nëpërmjet të cilit debitori duhet të përmbushë një detyrim të caktuar, vlera e tarifës fikse

përlllogaritet në masën e 1 page bazë minimale mujore.

4. Pika 4 ndryshon me përmbajtjen, si vijon:

“4. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përbarimor, kur titulli ekzekutiv është vendim i gjykatës për sigurimin e padisë, përlllogaritet si më poshtë:

a) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është deri në 500,000 lekë, tarifa është 1/4 e pagës bazë minimale mujore.

b) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 500,000 lekë deri në 2,000,000 lekë, tarifa është 1/2 e pagës bazë minimale mujore.

c) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 2,000,000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me 1 pagë bazë minimale mujore.

d) Nëse vendimi për sigurimin e një padie përmban një detyrim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, tarifa e subjektit përbarimor është një shumë e barabartë me 1/3 e pagës bazë minimale mujore.”

5. Pika 5 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“5. Mbi vlerën e tarifës fikse të përlllogaritur nga përmbartuesi gjyqësor sipas pikave 2, 3 dhe 4 të këtij seksioni, aplikohet TVSH-ja, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.”

6. Pika 10 dhe 11 e këtij seksioni, shfuqizohet.

II. Në seksionin IV bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“1. Shpenzimet e tjera sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duke përfshirë: shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;

a) Shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përbarimore;

b) Shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin dhe ruajtjen e sendeve të sekuestruara ose pasurisë së sekuestruar;

c) Shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;



d) Shpenzimet në lidhje me caktimin e përfaqësuesit ligjor të palës debitore, shpenzimet e kryera për veçimin e pjesës takuese të palës debitore dhe shpenzimet për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së palës debitore;

e) Shpenzime në lidhje me publikimin e ankandit;

f) Shpenzimet e kryera për dorëzimin e barrës/ve siguruese;

g) Shpenzimet e ndihmës ligjore të përdorura nga subjekti përmbarues (brenda tarifave të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve), me qëllim zgjidhjen e çështjeve ligjore, me objekt kundërshtim veprimesh përmbarimore dhe pavlefshmëri titulli ekzekutiv. Në rastet kur me vendim gjyqësor të formës së prerë konstatohet pavlefshmëria e veprimeve përmbarimore për shkak zbatimi gabim apo moszbatim të ligjit nga përmbaruesi gjyqësor privat, ky i fundit nuk mund të faturojë shpenzimin te kreditori. Nëse këto shpenzime janë parapaguar nga kreditori, subjekti përmbarues do t'ia rikthejë ato kreditorit;

h) Shpenzimet për veprimet procedurale pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas tarifave zyrtare të miratuara në zbatim të legjislacionit në fuqi “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.”.

2. Pika 4 ndryshon me këtë përmbajtje:

“4. Për shpenzimet e parashikuara në pikën 1 të këtij seksioni, subjekti përmbarues lëshon faturë tatimore ndaj palëve kreditore apo debitore, e cila shoqërohet me kopje të dokumenteve të pagesave të lëshuara nga të tretët, dokumente të cilat shërbejnë për të dokumentuar shpenzimet e zbritshme të subjektit përmbarues, sipas legjislacionit në fuqi”.

3. Pika 5 ndryshon si vijon:

“5. Shpenzimet përmbarimore të pagueshme nga subjekti përmbarues dhe të kryera në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas masës dhe llojeve në zbatim të këtij udhëzimi, përpara përfundimit të ekzekutimit, përshkruhen në një akt përmbledhës, të emërtuar “Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit”, duke bashkëlidhur faturat përkatëse. Pala debitore së cilës i ngarkohen këto shpenzime, ka të drejtë të njihet dhe të marrë kopje të këtij procesverbal.”.

III. Në seksionin VI, togfjalëshi “... iu shtohet edhe TVSH...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... aplikohet TVSH...”.

IV. Zbatimi i udhëzimit dhe hyrja në fuqi

“Për procedurat përmbarimore që kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, subjektet përmbaruese (persona juridikë apo fizikë) zbatojnë tarifat e përcaktuara në udhëzimin nr. 385/7, datë 28.6.2017, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

Përfundimisht, në rastet kur tarifat përmbarimore nuk janë parapaguar nga kreditori i procesit përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi për shkaqe të përjashtimit ligjor, aplikohen tarifat fikse të parashikuara në këtë udhëzim.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 31, datë 30.8.2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 385/6, DATË 26.6.2017, “PËR PËRCAKTIMIN E NIVELIT MINIMAL DHE MAKSIMAL TË ZBATIMIT TË VLERËS SË TARIFËS SË SUKSESIT PËR VEPRIMET PËRMBARIMORE TË OFUARA NGA SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR PRIVAT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 10, shkronja “e”, të nenit 48, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 385/6, datë 26.6.2017, “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat”, bëhen këto ndryshime:



I. Në seksionin II:

1. Në pikën 1 shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon:

“Në rast të marrjes pjesë në ekzekutim edhe të kreditorëve të tjerë të po atij debitori, secili prej tyre ka të drejtë të përcaktojë se cila do të jetë vlera e tarifës së suksesit.”.

2. Pika 7 ndryshon me këtë përmbajtje:

“7. Tarifa e suksesit e caktuar në marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe përmbaruesit gjyqësor privat, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në vlerë:

a) Deri në 500,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave;

b) Mbi 500,000 lekë deri në 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 10 % e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave;

c) Mbi 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 5% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar dhe/ose vendimit të ndërmjetëm të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave, por jo më shumë se 10,000,000 lekë.”.

3. Pas pikës 7 shtohen pikat 8, 9 dhe 10, me përmbajtje si vijon:

“8. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori në përfundim të procesit të ekzekutimit ose në përfundim të veprimeve të caktuara, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar nga kreditori dhe përmbaruesi gjyqësor privat kur kanë dakordësuar zbatimin e tarifës së suksesit për titullin ekzekutiv në fjalë.

9. Në çdo rast, mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH, e cila llogaritet në momentin e pagesës dhe vetëm për atë pjesë që arkëtohet nga përmbaruesi gjyqësor, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.

10. Tarifa e suksesit, e përlllogaritur dhe e faturuar pjesërisht apo plotësisht nga përmbaruesi gjyqësor, paguhet nga kreditori dhe nuk i ngarkohet debitorit.”.

II. Në seksionin III:

1. Pika 2 ndryshon me këtë përmbajtje:

“2. Bazuar në kriteret si më sipër treguar, tarifa e suksesit për veprime përmbarimore të kryera do të jetë një vlerë monetare, e cila nuk mund të jetë më

pak se 1,000 (një mijë) lekë dhe jo më shumë se 100, 000 (njëqind mijë) lekë”.

2. Në pikën 4, togfjalëshi “... tarifës së suksesit i ngarkohet TVSH-ja...” zëvendësohet me togfjalëshin “... mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH-ja ...”.

III. Zbatimi i udhëzimit dhe hyrja në fuqi

Ky udhëzim rregullon marrëdhëniet midis palës kreditore dhe subjektit përmbarues, të lindura pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Etilda Gjona (Saliu)

MINISTRI I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 32, datë 30.8.2018

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN
E PËRBASHKËT NR. 1276/5, DATË
27.7.2017, “PËR KAKTIMIN E TARIFAVE
PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA
SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR
SHTETËROR”, TË MINISTRIT TË
DREJTËSISË DHE MINISTRIT TË
FINANCEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të neneve 12 dhe 12/a, të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 1276/5, datë 27.7.2017, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, bëhen këto ndryshime:

I. Në seksionin III:

1. Pika 2 riformulohet me këtë përmbajtje:

“2. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbarimor, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar si kthim shume dhe/ose pagim detyrimi, përlllogaritet si më poshtë:

a) Tabela e tarifave fikse përmbarimore në lek, sipas vlerave të detyrimit:



Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në lekë mbi vlerën e detyrimit)
1 – 10,000	6,000
10,001 – 20,000	7,000
20,001 – 30,000	8,000
30,001 – 40,000	9,000
40,001 – 50,000	10,000
50,001 – 60,000	11,000
60,001 – 70,000	12,000
70,001 – 80,000	13,000
80,001 – 90,000	14,000
90,001 – 100,000	15,000
100,001 – 150,000	17,000
150,001 – 200,000	18,000
200,001 – 250,000	20,000
250,001 – 300,000	22,000
300,001 – 350,000	24,000
350,001 – 400,000	26,000
400,001 – 450,000	28,000
450,001 – 500,000	30,000

b) Tabela e tarifave fikse përmbartimore në %, sipas vlerave të detyrimit:

Vlera e detyrimit nga ... lekë deri në ... lekë	Tarifa fikse (në përqindje mbi vlerën e detyrimit)
500,001 – 2,000,000	5.5%
2,000,001 – 5,000,000	3.85%
5,000,001 – 10,000,000	2.75%
10,000,001 – 30,000,000	2.2%
30,000,001 – 90,000,000	1.65%
Mbi 90,000,000	1.1% Minimumi 1, 485,000 lekë Maksimumi 2, 500,000 lekë

2. Pika 4 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

“4. Vlera e tarifës fikse të shërbimit përmbartimor, kur titulli ekzekutiv është vendim i gjykatës për sigurimin e padisë, përlllogaritet si më poshtë:

a) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është deri në 500,000 lekë, tarifa është 1/4 e pagës bazë minimale mujore.

b) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë është më shumë se 500,000 lekë deri në 2,000,000 lekë, tarifa është 1/2 e pagës bazë minimale mujore.

c) Nëse vendimi për sigurimin e padisë përmban një detyrim monetar dhe vlera e padisë

është më shumë se 2,000,000 lekë, tarifa është një shumë e barabartë me 1 pagë bazë minimale mujore.

d) Nëse vendimi për sigurimin e një padie përmban një detyrim jomonetar ose vlera e padisë nuk është e përcaktuar, tarifa e subjektit përmbartimor është një shumë e barabartë me 1/3 e pagës bazë minimale mujore.”

4. Në pikën 6, togfjalëshi “... i shtohet TVSH-ja ...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... i aplikohet TVSH-ja ...”.

5. Pika 11 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“11. Tarifa për ekzekutimin e titujve ekzekutivë sipas këtij seksioni, në çdo rast nuk mund të jetë më e madhe se 2,500,000 lekë, pavarësisht vlerës së detyrimit.”.



II. Në seksionin IV:

1. Pika 1 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

“1. Shpenzimet e tjera sipas nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile përbëhen nga shpenzimet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, duke përfshirë:

a) Shpenzimet për administrimin e të dhënave të nevojshme për kryerjen e procedurave të ekzekutimit;

b) Shpenzimet për korrespondencën në lidhje me procedurën përbarimore;

c) Shpenzimet në lidhje me transportin, magazinimin dhe ruajtjen e sendeve të sekuestruara ose pasurisë së sekuestruar;

d) Shpenzimet në lidhje me hapjen, inventarizimin, mbylljen, lëvizjen, prishjen dhe pastrimin e ambienteve ose subjekteve të tjera në proces ekzekutimi;

e) Shpenzimet në lidhje me caktimin e përfaqësuesit ligjor të palës debitoare, shpenzimet e kryera për veçimin e pjesës takuese të palës debitoare dhe shpenzimet për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së palës debitoare;

f) Shpenzime në lidhje me publikimin e ankandit;

g) Shpenzimet e kryera për dorëzimin e barrës/ve siguruese;

h) Shpenzimet e ndihmës ligjore të përdorura nga subjekti përbarues (brenda tarifave të përcaktuara nga udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatëve), me qëllim zgjidhjen e çështjeve ligjore, me objekt kundërshtim veprimesh përbarimore dhe pavlefshmëri titulli ekzekutiv. Në rastet kur me vendim gjyqësor të formës së prerë konstatohet pavlefshmëria e veprimeve përbarimore, për shkak zbatimi gabim apo moszbatim të ligjit nga përbaruesi gjyqësor shtetëror, ky i fundit nuk mund të faturojë shpenzimin te kreditori. Nëse këto shpenzime janë parapaguar nga kreditori, subjekti përbarues do t’ia rikthejë ato kreditorit.

i) Shpenzimet për veprimet procedurale pranë Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, sipas tarifave zyrtare të miratuara në zbatim të legjislacionit në fuqi “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.”.

2. Pika 4 ndryshon me këtë përmbajtje:

“4. Për shpenzimet e parashikuara në pikën 1 të këtij seksioni, subjekti përbarues lëshon faturë tatimore ndaj palëve kreditore apo debitoare, e cila shoqërohet me kopje të dokumenteve të pagesave të lëshuara nga të tretët, dokumente të cilat shërbejnë për të dokumentuar shpenzimet e zbritshme të subjektit përbarues, sipas legjislacionit në fuqi.”.

3. Pika 5 ndryshon si vijon:

“5. Shpenzimet përbarimore të pagueshme nga subjekti përbarues dhe të kryera në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas masës dhe llojeve në zbatim të këtij udhëzimi, përpara përfundimit të ekzekutimit, përshkruhen në një akt përmbledhës, të emërtuar “Procesverbal për shpenzimet procedurale gjatë ekzekutimit”, duke bashkëlidhur faturat përkatëse. Pala debitorë, së cilës i ngarkohen këto shpenzime, ka të drejtë të njihet dhe marrë kopje të këtij procesverbali.”.

III. Në seksionin V:

1. Në pikën 4, togfjalëshi “... u shtohet TVSH-ja ...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... u aplikohet TVSH-ja ...”.

IV. Në seksionin VI, togfjalëshi “... iu shtohet vlera përkatëse TVSH-së”, zëvendësohet me togfjalëshin “... iu aplikohet vlera përkatëse e TVSH-së”.

V. Zbatimi i udhëzimit dhe hyrja në fuqi

“Për procedurat përbarimore që kanë filluar dhe nuk kanë përfunduar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, subjektet përbaruese (persona juridikë apo fizikë) zbatojnë tarifat e përcaktuara në udhëzimin nr. 1276/5, datë 27.7.2017, “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Shërbimi Përbarimor Gjyqësor Shtetëror.”.

Përfundimisht, në rastet kur tarifat përbarimore nuk janë parapaguar nga kreditori i procesit përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi për shkaqe të përjashtimit ligjor, aplikohen tarifat fikse të parashikuara në këtë udhëzim.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Etilda Gjona (Saliu)

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 33, datë 30.8.2018****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR.
1276/6, DATË 27.7.2017, “PËR
PËRCAKTIMIN E NIVELIT MINIMAL
DHE MAKSIMAL TË ZBATIMIT TË
VLERËS SË TARIFËS SË SUKSESIT PËR
VEPRIMET PËRMBARIMORE TË
OFRUARA NGA SHËRBIMI
PËRMBARIMOR GJYQËSOR
SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të neneve 12 dhe 12/b, të ligjit nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 1276/6, datë 27.7.2017, “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbarrimore të ofruara nga Shërbimi Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror”, bëhen këto ndryshime:

I. Në seksionin II:

1. Në pikën 7, togfjalëshi “... tarifës së suksesit i ngarkohet TVSH-ja...”, zëvendësohet me togfjalëshin “... mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH-ja”.

II. Në seksionin III:

1. Pika 1 ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar, pala kreditore dhe subjekti përmbarrues, sipas vullnetit të tyre, mund të parashikojnë në marrëveshje masën e tarifës së suksesit, por në çdo rast kjo tarifë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës së ekzekutuar të detyrimit.

Në rast të marrjes pjesë në ekzekutim edhe të kreditorëve të tjerë të po atij debitori, secili prej tyre ka të drejtë të përcaktojë se cila do të jetë vlera e tarifës së suksesit.”.

2. Pika 3 ndryshon me këtë përmbajtje:

“3. Tarifa e suksesit e caktuar në marrëveshje ndërmjet kreditorit dhe përmbarruesit gjyqësor shtetëror, kur titulli ekzekutiv përmban një detyrim monetar në vlerë:

a) Deri në 500,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 20% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose kombinimit të të dyjave;

b) Mbi 500,000 lekë deri në 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 10% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar, ose kombinimit të të dyjave;

c) Mbi 90,000,000 lekë nuk mund të jetë më e vogël se 1% dhe jo më e madhe se 5% e vlerës totale të detyrimit të vjelë ose titullit të ekzekutuar dhe/ose vendimit të ndërmjetëm të ekzekutuar ose kombinimit të të dyjave, por jo më shumë se 10,000,000 lekë.”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6, me përmbajtje si vijon:

“4. Tarifa e suksesit paguhet në çdo rast nga kreditori në përfundim të procesit të ekzekutimit ose në përfundim të veprimeve të caktuara, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në kontratën e nënshkruar nga kreditori dhe përmbarruesi gjyqësor shtetëror kur kanë dakordësuar zbatimin e tarifës së suksesit për titullin ekzekutiv në fjalë.

5. Në çdo rast, mbi tarifën e suksesit aplikohet TVSH-ja, e cila llogaritet në momentin e pagesës dhe vetëm për atë pjesë që arkëtohet nga përmbarruesi gjyqësor, bazuar në kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshje.

6. Tarifa e suksesit, e përlllogaritur dhe e faturuar pjesërisht apo plotësisht nga përmbarruesi gjyqësor, paguhet nga kreditori dhe nuk i ngarkohet debitorit.”.

III. Në seksionin IV:

1. Pika 2 ndryshon me këtë përmbajtje:

“2. Bazuar në kriteret si më sipër treguar, tarifa e suksesit për veprime përmbarrimore të kryera do të jetë një vlerë monetare, e cila nuk mund të jetë më pak se 1,000 (një mijë) lekë dhe jo më shumë se 100,000 (njëqind mijë) lekë.”.

IV. Zbatimi i udhëzimit dhe hyrja në fuqi

Ky udhëzim rregullon marrëdhëniet midis palës kreditore dhe subjektit përmbarrues, të lindura pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)
MINISTRI I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë